



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUCIONI I PREFEKTIT TE QARKUT SHKODER



RAPORT

PËR VEPRIMTARINË E KRYER NGA INSTITUCIONI GJATË VITIT 2017

RAPORT

Për veprimtarinë e kryer nga Insitucioni i Prefektit të Qarkut gjatë vitit 2017

Qellimi i raportit është të ofrojë një përmbledhje të veprimtarisë së kryer për vitin 2017, përgjegjësi e drejtuesve të Institucionit, në përputhje me kerkesat e Ligjit 107/2016, datë 27.10.2016 “*Për Prefektin e Qarkut*”

Hartuar nga: Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara

Adresa: Rruga “28 Nëntori” Shkodër, tel /faks. 00355 2224 2705, e-mail: prefekturashkodër@yahoo.com

Shkoder, Shkurt 2018

Misioni i prefektit të qarkut është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Keshillit të Ministrave (*Arritja e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike me rezultate konkrete në punësim dhe në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve; Program që ka në bazë përpjekjet për rritjen e stabilitetit makroekonomik si një parakusht i rëndësishëm për një rritje të qëndrueshme ekonomike*), në nivel qarku

Përmbajtja

I.	Hyrje.....	6
II.	Përmbledhje	7
III.	Baza Ligjore	11
IV.	Realizimi i detyrave dhe prioriteteve, në lidhje me programin e qeverisë.....	12
IV.1.	Programimi dhe realizimi i të ardhurave.....	12
IV.2.	Realizimi i Investimeve.....	14
V.	Marrëdhëniet e Prefektit me Administratën e shtetit (Administratën Qendrore, Ministrinë, Institucionet qendrore në nivel vendor-Degët Territoriale).....	16
V.1.	Institucionet në nivel vendor dhe veprimtaria e tyre.....	17
V.2.	Problemet e rendit dhe të sigurisë, rekomandime për përmirësimin e punës në vazhdim.....	23
V.3.	Problemet e konstatuar nga analizat mujore të punës së institucioneve qendrore në nivel vendor.....	25
V.4.	Grupet e punës ndërinstucionale (task-forcat).....	25
V.4.1.	Task Forca Vendore antikanabis.....	26
V.4.2.	Zbati i i masave, lidhur me çeshtjet e luftës kundër trafikimit të personave.....	27
V.6.	Masat e marra për përbalimin e situatave nga emergjencat.....	29
VI.	Marrëdhëniet e Prefektit me njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë).....	34
VI.1.	Kryerja e funksioneve të transferuara njësite të vetëqeverisjes vendore.....	34
VI.2.	Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore dhe asistencë juridike për vendimmarrjen e këtyre akteve.....	38
VI.3.	Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për rritjen e performancës së të zgjedhurve vendor.....	43
VII.	Funksionet e deleguara, kryerja e veprimtarisë nga institucionet të cilave u janë deleguar funksionet nga institucionet qendrore.....	43
VII.1.	Verifikimi i titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore	43
VII.2.	Shërbimet sociale	45
VII.3.	Zhvillimi i territorit.....	46
VII.4.	Zhvillimi i turizmit.....	47
VII.5.	Shërbimi i Gjëndjes Civile.....	50
VIII.	Organizimi dhe veprimtaria e administratës së Prefektit.....	51
VIII.1.	Organizimi.....	51
VIII.2.	Urdhërat e nxjerra dhe zbatimi i tyre.....	54

VIII.3. Takimet e organizuara në funksion të kryerjes së veprimtarisë.....	54
VIII.4. Vlerësimi dhe trajtimi i ankesave të shtetasve.....	56
VIII.5. Veprimtaria e N/Prefektit.....	57
IX. Veprimtari të tjera të Prefektit.....	57
X. Objektivat për vitin 2018.....	58

RAPORT

Për veprimtarinë e kryer nga Institucioni i Prefektit të Qarkut gjatë vitit 2017

I. HYRJJE

Raporti, i cili paraqet veprimtarinë dhe performancën e Institucionit është në pajtueshmëri me kërkesën për rritjen e profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së administrates publike

Raporti pasqyron realizimin e detyrave dhe prioriteteve, në përputhje me programin qeverisës. Në raportin pasqyrohet programimi dhe realizimi i të ardhurave dhe investimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore (Këshilli i Qarkut dhe Bashkitë, brenda territorit të qarkut), si dhe nga institucionet qendrore në nivel vendor; Treguesit e punës; marrëdhëniet e Prefektit me administratën qendrore dhe rajonale, si dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë); Bashkëpunimi dhe koordinimi punës për realizimin e detyrave të ngarkuara; Verifikimi i ligjshmërisë së akteve normative të nxjerra nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore; Problemet e rendit e sigurisë publike; Veprimtaria e kryer në parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit; Veprimtaria në çështjet e luftës kundër trafikimit të personave, si dhe rekomandimet për përmirësimin e punës në vazhdim; Kryerja e funksioneve të transferuara nga Institucionet qendrore njësive të vetëqeverisjes vendore (Shërbimi Mbrojtjes nga Zjarri, administrimi i pyjeve, sistemi i ujitjes dhe kullimit, menaxhimi i rrjetit të rrugëve rurale, sistemi i arsimit parashkollor). Vëmendje e veçantë i kushtohet zhvillimit të turizmit; Përballimit të situatave të emergjencave civile; Kryerjes së funksioneve të deleguara; Vlerësimit të titujve të pronësisë mbi token bujqësore. Po kështu në raport trajtohen problemet e ndjekjes dhe shqyrtimit të kerkesave dhe ankesave të ndryshme të qytetarëve; Urdhrat e nxjerra nga ana e Prefektit dhe zbatimi i tyre; Problemet e konstatuara gjatë analizave vjetore të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor, etj.

Për hartimin e raportit përveç të dhënave të institucionit dhe të dhënave monitoruese, janë përdorur edhe të dhënat e institucioneve qendrore në nivel qarku, si dhe të dhënat e njësive të vetëqeverisjes vendore

II. PËRMBLEDHJE

- Gjatë vitit, si rezultat i rritjes së nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit të punës, është përmirësuar performanca e institucioneve qendrore në nivel vendor si dhe e njësive të vetëqeverisjes vendore. Me transferimin e funksioneve, i cili është shoqëruar edhe burimet e nevojshme financiare (Fondet e buxhetit, në formën e transfertës specifike, për ushtrimin e funksioneve të transferuara, gjatë vitit janë rritur në masën 14.8 %, krahasuar me vitin e kaluar), tek njësitë e vetëqeverisjes vendore, është mundur që shërbimet të jenë më afër qytetarit

- Arritjet në realizimin e detyrave dhe prioriteteve, në përputhje me programin qeverisës, janë rezultat i rritjes së nivelit të profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së administratës publike.

- *Të ardhurat e realizuara në nivel qarku*

- Tatime, taksa nacionale dhe kontribut për sigurime shoqërore e shëndetësore, të arkëtuara nepermjet Drejtorisë Rajonale të Tatimeve janë realizuar me një vlerë prej 5,022,568 mijë lekë, ose 103 % e të ardhurave të programuara, me një rritje prej 173,044 mijë lekë nga vitit i kaluar. Realizimi i të ardhurave është rezultat i bashkëpunimit të të gjitha institucioneve në goditjen e informalitetit. Për shkeljet e konstatuara gjatë kontrolleve dhe verifikimeve të ushtruara në terren nga ana e Drejtorisë Hetimit Tatimor në 6500 subjekte, janë: Referuar në prokurori 45 subjekte, ose 26 subjekte më shumë se në vitin e kaluar; Propozuar për kontroll të thelluar 19 subjekte; Marrë masa administrative, penalitete në 1383 raste me vlerë 60,770 mijë lekë; Mbyllur 11 subjekte pa licencë; Ndryshuar përgjegjësia tatimore për 47 subjekte; Bllokuar 7 subjekte, për moslëshim kupon tatimor-hera dytë.

- Të ardhura doganore, nga Dega e Doganës, janë realizuar me vlerë 4,049,000 mijë lekë, ose 102 % e të ardhurave të programuara, me një rritje nga nga vitit i kaluar prej 432,000 mijë lekë.

- Të ardhura të njësive të vetëqeverisjes vendore (Këshilli i qarkut dhe bashkitë) janë realizuar me një vlerë prej 781,184 mijë lekë, ose 83.2 % e të ardhurave të programuara, me një mosrealizim prej 157,802 mijë lekë (peshën më të madhe me 129,334 mijë lekë, ose 82 % të mosrealizimit e zë bashkia Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe), me një rënie prej 49,449 mijë lekë, krahasuar me vitin e kaluar janë tejkaluar.

Në realizimin e të ardhurave, ndikim të rëndësishëm ka patur rritja e të ardhurave nga turizmi, duke reflektuar zhvillimin që ka marrë ky sektor i ekonomisë, në saje të masave, bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarive të institucioneve qendrore, si dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, shoqatat dhe subjektet që zhvillojnë aktivitete në fushën e turizmit, si dhe investimeve të kryera në infrastrukturë, në shërbim të këtij sektori, në zbatim të programit të qeverisë. Me gjithë progresin e bërë (Krahasuar me vitin e kaluar, është rritur numri i shtetasve dhe mjeteve të përpunuara në pikat doganore me 20.3 dhe 18.2 %; Numri i pushuesve të akomoduar në strukturat akomoduese me rreth 2 herë; Numri i subjekteve private të regjistruara, të cilat ushtrojnë veprimtari biznesi me 89 subjekte: Xhiroja e subjekteve deklaruese me 51 %), gjatë vitit janë hasur edhe probleme (Gjëndja e rrugëve; Trafiku i rënduar i mjeteve gjatë sezonit; Administrimi dhe menaxhimi i territorit dhe hapësirave publike; Mos zbatimi i kriterëve dhe standardeve të përcaktuara në rregulloren

“Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së plazhit”; Mos zbatimi i kushteve për krijimin e sigurisë në pazh; Mungesa e trajnimeve dhe Udhërrefyesve turistik; etj), të cilat kanë ndikuar në mbarëvajtjen dhe zhvillimin e turizmit

- *Investimet*

- Janë kryer investime në njësitë e vetëqeverisjes vendore (me fondet e buxhetit të shtetit dhe fondet e veta) me një vlerë prej 1,382,984 mijë lekë (Këshilli i qarkut 2,498 mijë lekë, bashkia Shkodër 307,936 mijë lekë, bashkia Malësi e Madhe 361,183 mijë lekë, bashkia Vau i Dejës 337,987 mijë lekë, bashkia Pukë 176,084 mijë lekë dhe bashkia Fushë Arëz 197,296 mijë lekë). Në investimet e kryera në njësitë e vetëqeverisjes vendore përfshihen edhe investimet në ndertimin dhe rikonstruksionin e 10 shkollave (Në bashkinë Malësi e Madhe, Rikonstruksion Shkollës 9-vjeçare “Prek Gjoni” Bajzë dhe “Rikonstruksion i shkollës Xhaj”; Në bashkinë Shkodër, Rikonstruksion i shkollës “T.Smajli”, Rikonstruksion i shkollës mesme “Oso Kuka”, Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Ura e Shtrenjtë” Postribë, Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare “Dëshmorët e Prishtinës”; Në bashkinë Vau i Dejës, Ndërtim i shkollës 9-vjeçare “Dom Martin Trushi” Stajkë-Bushat, Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Toplanë; Në bashkinë Pukë, Rikonstruksion i shkollës mesme “Sabah Sinani” dhe ndertim palestre pranë kësaj shkolle)

- Janë kryer investime në sektorin e energjisë me fondet nga të ardhurat e Shoqërive Aksionare me vlerë 1,182,987 mijë lekë (OShEE Sh.A 340,894 mijë lekë dhe KESh Sh.A 842,093 mijë lekë), investime të cilat, falë edhe masave të marra dhe bashkëpunimit me institucionet dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me strukturat e policisë vendore, kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të furnizimit me energji elektrike (furnizim pa ndërprerje të konsumatorëve), si dhe në zvogëlimin e nivelit të humbjeve

- Kanë filluar gjatë vitit 2017 dhe janë në proces realizimi investime me vlerë 3,688,085 mijë lekë në 5 bashkitë e qarkut; Në bashkinë Malësi e Madhe 113,955 mijë lekë në 2 objekte (“Rikualifikim i qendrës Bajzë” 30,000 mijë lekë dhe “Rehabilitim i qendrës qytetit Koplik” 83,955 mijë lekë; Nepërmjet FShZh me vlerë 3,574,130 mijë lekë në 4 bashki, Në bashkinë Shkodër me vlerë 2,297,145 mijë lekë (Në objektin “Rikonstruksion i rruges Shkoder Velipoje segmenti Harku i Berdices – Baks, Lot I-rë, II-të dhe III-të), Në bashkinë Vau i Dejës me vlerë 178,960 mijë lekë (Në objektin “Rikonstruksion i unazes qyteti Vau Dejes”), Në bashkinë Pukë me vlerë 173,522 mijë lekë (Në objektin “Rikualifikim i qendrës dhe liqenit të vogël në Pukë”) dhe në bashkinë Fushë Arëz me vlerë 924,503 mijë lekë (Në objektin “Rikonstruksion-Rehabilitim dhe veshje me asfalt, i rrugës F.Arëz –Reps”).

- Janë në proces investime, në sektorin e energjisë, nga KESh Sh.A me vlerë 10,635 mijë € (Rahabilitim me rinovim teknologjik të kuzhinetave mbështetëse të 5 agregatëve, HEC V.Dejës), investim i cili ka filluar dhe do të përfundojë brenda një afati 3 vjeçar.

- Janë përmirësuar kushtet për zhvillimin e një procesi normal mësimor; Janë krjuar struktura mbështetëse për zhvillimin e mësimin nxënësve me aftësi ndryshe; Nuk ka nxënës të cilët kanë braktisë shkollën, për shkak të gjakmarrjes (vitin e kaluar ka patur 3 nxënës të cilët kanë braktisë shkollën për këtë shkak); Gjatë vitit nuk ka mesues pa arsimin përkatës dhe jashte profilit. Për arsye të ngarkesës dhe rikonstruksionit të godinës së shkollës , procesi mësimor në 10 shkolla zhvillohet me 2 turne (Në bashkinë Shkodër në 9 shkolla dhe në bashkinë Malësi e Madhe në 1 shkollë). Ambientet në të cilat zhvillohet mësimi, për shkak të amortizimit të ndërtesave, nuk janë të përshtatshme dhe brenda kushteve për zhvillimin normal të procesit mësimor, kështu që kërkohet marrja e masave për përmirësimin e gjendjes

së tyre, nepermjet rikonstruksionit në (Në bashkinë Shkodër 5 Shkolla; Në bashkinë Malësi e Madhe 3 shkolla; Në bashkinë Pukë 1 shkollë; Në bashkinë Fushë Arëz 2 shkolla)

- Është rritur numri i të punësuarve (numri i personave, për të cilët është llogaritur dhe derdhur kontribut për sigurime shoqërore e shëndetësore) gjatë vitit me 655 vetë, krahasuar me vitin e kaluar (31 453 vetë nga 30 798 vetë që ka qenë në vitin e kaluar), rritje e cila ka ardhur nga kryesisht nga punësimi në sektorin privat, duke bërë që të ketë rënie të numrit të punëkërkuësve të papunë të regjistruar. Numri i punëkërkuësve të papunë të regjistruar në fund të vitit ka qenë 7055 persona, nga 7920 që ishte në fund të vitit të kaluar, ose 865 persona më pak.

Gjatë vitit është intensifikuar goditja ndaj informalitetit, çka shihet edhe në treguesit e rritjes së të ardhurave, të subjekteve private të regjistruara dhe në numrin e të punësuarve.

Në fund të vitit mundësitë e punësimit janë për 478 persona, vende të lira punë në sektorin e fasonerisë (rrobaqepsi, kepuçë), përpunim peshku, FA, etj.

- Me fondet e buxhetit janë kryer shpenzime gjatë vitit, për ndihmë ekonomike dhe pagesë të personave me aftësi të kufizuar, me vlerë 1,725,645 mijë lekë (Pagesë ndihme ekonomike 443,557 mijë lekë dhe pagesë paaftësie 1,282,088 mijë lekë), me një trajtim mesatar mujor 8,859 familje dhe 11,607 persona

Si rezultat i masave të marra nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, nepermjet inspektimeve dhe kontrolleve të ushtruara në njësitë e vetëqeverisjes vendore, për administrimin e fondeve të ndihmës ekonomike dhe pagesës paaftësisë, janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike 443 familje dhe 95 persona, të cilat e përfitonin në shkelje të ligjit.

- Situatat e emergjencave të krijuara gjatë gjithë vitit në territorin e qarkut (situatat dimerore të krijuara nga reshjet dhe ato verore nga renia e zjarreve) si rezultat i bashkëpunimit dhe koordinimit të punës me njësitë e vetëqeverisjes vendore, strukturat e policisë së shtetit, autoritetin rajonal të rrugëve, shërbimin pyjor, strukturat e MM, me mbështetjen e vazhdueshme të MPB (Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile) janë përballuar në mënyrën me të mirë të mundshme (Gjatë stinës së verës janë shfaqur 682 vatra zjarri, të cilat kanë përshkuar një sip. prej 1603 Ha pyje dhe kullota, duke djegur 804.7 Ha)

- Kriminaliteti gjatë vitit, krahasuar me vitin 2016, është ulur në masën 13.1 %, ose me 347 vepra penale më pak (Nga 2653 vepra penale të evidentuara gjatë vitit 2016 në vitin 2016 janë evidentuar 2306).

- Krahasuar me vitin e kaluar, si rezultat i sensibilizimit, ndërgjegjësimit, bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimtarisë në mes të të gjitha institucioneve të përfshira në Task Forcën Vendore dhe me Njësitë e vetëqeverisjes Vendore, për realizimin e detyrave të përcaktuara në planet operationale të tyre (në zbatim të planit kombëtar kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020), është zvogëluar sip. dhe numri i bimëve të kanabisit të kultivuara mbi 26 herë. Po kështu është rritur shkalla e zbulueshmërisë me 46 % (nga 12 % në 58 %) dhe forca goditëse (gjatë vitit 2017 janë ndjekur penalisht 96 autorë, nga 76 autorë të ndjekur gjatë vitit të kaluar, ose 20 autor më shumë).

- Trafikimi i personave, ka patur rënie të treguesve të evidentimit, që ka ardhur si rezultat i rritjes së nivelit të bashkëpunimit të Komitetit Rajonal Antitrafik, strukturave të policisë së shtetit, njërive të vetëqeverisjes vendore, institucioneve qendrore në nivel vendor, shoqatave dhe individëve të ndryshëm, si dhe koordinimit të veprimtarisë nga Institucioni i Prefektit.

- Nga ana e Prefektit ne permbushje te misionit, ushtrimit te pergjegjesive dhe veprimtarise jane nxjerre 55 Urdhra; Jane zhvilluar takime te shumta si me grupin keshillues pranë Prefektit, ashtu edhe me drejtues te institucioneve qendrore ne nivel vendor, te njesive te veteqeverisjes vendore, etj., per problemet e emergjencave civile, mbarevajtjen e sezonit turistik, titujt e pronesisë mbi token bujqesore, ligjshmerine e akteve te nxjerra nga njesite e veteqeverisjes vendore, etj ; Jane shqyrtuar dhe vleresuar, duke u kthyer pergjigje, 80 kerkesa dhe ankesa te ndryshme te qytetarve.

- Institucioni i Prefektit gjatë vitit ka qenë pjesë përbërse e grupit ndërinstucional (Task Forcës), të ngritur, lidhur me: Kontrollin efikas të territorit me qëllim parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit; Çështjet e luftës kundër trafikimit të personave; Monitorimin e veprimtarisë së therjes së kafshëve dhe transportit e tregtimit të mishit; Monitorimin e zbatimit të plan veprimit të miratuar “Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2017”; Monitorimin dhe kontrollin e masave, për zbatimin e detyrimeve ligjore për sigurinë në plazhe; Kontrollin dhe monitorimin e menaxhimit të mbetjeve, brenda territorit të qarkut, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore; Identifikimin e Nevojave për Reabilitimin e Shtretërve të Lumenjëve; Marrjen e masave emergjente mbrojtëse për parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim në pyje publike e private

- Nga 459 akte të depozituara, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në Institucionin e Prefektit, për verifikim ligjshmërie, Prefekti ka vlerësuar se janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore 345 akte; Është shprehur negativisht, për shkak se kanë qenë jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, për 114 akte, nga të cilat janë rishqyrtuar 30 prej tyre, ndërsa 1 rast është dërguar në Gjykatë. Ka vazhduar asistimi me ndihmë juridike në mënyrë qoftë verbalisht apo edhe me dhënie Udhëzimesh, Rekomandimesh, deri edhe në takime lidhur me problemet që kanë organet e njësive të vetëqeverisjes vendore në interpretimin e ligjit dhe zbatimin e drejtë të tij

- Nga ana e Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore janë ushtruar kontrollet direkte per verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të AMTP – ve të plotësuar në tokat bujqësore te ish NB te qarkut në 303 raste (Në fshatrat Bërdicë e Sipërme, Bërdicë e Mesme dhe Bërdicë e Madhe, të Nj.A Bërdicë- pjesë e ish NB “Bërdicë”, Rranxa, NjA Bushat, pjesë e ish NB Bushat dhe Shtoj i Ri dhe Grudë e Re, Nj.A Rrethina- pjesë e ish NB “P.Rexhepi”), nga të cilat janë rajtuar me vendim 62, janë pezulluar 39 dhe janë në proces 202; Janë trajtuar 101 kerkesa, nga të cilat janë kryer procedurat me përgjigje administrative 67 dhe në proces 41 kerkesa. Nga ana e Komisionit janë trajtuar me vendime 135 AMTP, nga të cilat shfuqizim i plotë 28, shfuqizim i pjesshëm 41, pezullim 65, mos shqyrtim 1. Për shfuqizim të plotë/pjesshëm 69 AMTP, siperfaqja e tokës e përfituar padrejtësisht 28.13 Ha ka kaluar në favor të shtetit.

III. BAZA LIGJORE

Veprimtaria e Institucionit të Prefektit mbështetet në:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë
- Ligjin Nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”
- Ligjin Nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, me ndryshime
- Ligji Nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i punës”, me ndryshime
- Ligji nr. 9367, date 07.04.2005 “Per parandalimin e konfliktit te interesave ne ushtrimin e funksioneve publike”, me ndryshime
- Ligji Nr. 119/2014, date 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit”
- Ligji Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”
- Ligji nr. 9131, date 08.09.2003 “Per rregullat e etikes se administrates publike”
- Ligji Nr. 9887, date 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me ndryshime
- Ligji Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligj Nr.9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"
- Ligji nr. 9154, date 06.11.2003 “Per arkivat”, me ndryshime
- Ligji nr 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime
- Ligji Nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- Ligji Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshime
- Ligji Nr.9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshime
- Ligji nr 9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në RSh”, me ndryshime
- Ligji nr 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, me ndryshime
- Ligji nr 9643 datë 20.11.2006 ”Për Prokurimin Publik”, me ndryshime
- Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshime
- Ligji Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshime
- Ligji Nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr. 112/2015, datë 15.10.2015 “Për inspektimin financiar publik”
- Ligji Nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, me ndryshime
- Ligj Nr. 9482, datë 06.02.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, me ndryshime
- Ligj Nr. 10 237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, me ndryshime
- Ligj Nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", me ndryshime
- Ligj Nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, me ndryshime
- Ligj Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”
- Ligj Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”

- Ligji 8756 date 26.03.2001 “Për Emegjencat Civile”, me ndryshime
- Ligji Nr. 10129 date 11.05.2009 “Per gjendjen civile”, me ndryshime
- Ligji Nr. 8951 datë 10.10.2002 “Për numrin personal të shtetasve”, me ndryshime
- Ligji Nr. 8952 datë 10.10.2002 “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqipëtar”, me ndryshime
- Ligji Nr. 10273 datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, me ndryshime
- Ligji nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”
- Ligji Nr. 9948 date 07.07.2008 “Per shqyrtimin e vlefshmerise ligjore te krijimit te titujve te pronesise mbi token bujqesore”
- Ligji Nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”
- Aktet nënligjore të dala, në dhe për zbatimin e ligjeve
- Rregulloren organizative të brendshme të administratës së Institucionit

IV. REALIZIMI I DETYRAVE DHE PRIORITETEVE, NË LIDHJE ME PROGRAMIN E QEVERISË

IV.1. Programimi dhe realizimi i të ardhurave

IV.1.a. Njësitë e vetëqeverisjes vendore

Janë realizuar të ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me një vlerë prej 781,184 mijë lekë, ose 83.2 % e të ardhurave të programuara, me një mosrealizim prej 157,802 mijë lekë, ku 82 % e mosrealizimit i përket bashkisë Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe (Bashkia Vau i Dejës me një mosrealizim prej 70,485 mijë lekë, ose 44.7 % dhe bashkia bashkia Malësi e Madhe me 58,849 mijë lekë, ose 37.3 %).

Programimi dhe realizimi i të ardhurave, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, për vitin 2017 paraqitet:

Në mijë lekë

Nr.	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore	Të ardhurat gjithësej				
		Viti 2017			Viti 2016	
		Program	Fakt	%	Fakt	%
1	Keshilli i Qarkut	2,800	681	24.3	4,291	100.0
2	Bashkia M. Madhe	103,000	44,151	42.9	135,106	77.8
3	Bashkia Puke	37,500	20,812	55.5	28,095	100.0
4	Bashkia Fushe-Arrez	21,000	20,992	100.0	20,371	100.0
5	Bashkia Vau i Dejes	153,000	82,515	53.9	105,683	65.2
6	Bashkia Shkoder	621,686	612,033	98.4	508,679	84.8
	Totali	938,986	781,184	83.2	802,225	81.2

Gjatë vitit 2017 realizimi i të ardhurave ka pësuar rënie krahasuar edhe me vitin e kaluar me një vlerë prej 49,449 mijë lekë, ose 5 %. Mosrealizimi i të ardhurave të programuara dhe rënia e nivelit të realizimit krahasuar me vitin e kaluar flet për një punë të pamjaftueshme të njësive të vetëqeverisjes vendore në shfrytëzimin e burimeve financiare, me ndikim në kryerjen e shërbimeve dhe investimeve, si dhe zhvillimit të njësive të vetëqeverisjes vendore

IV.1.b. Të ardhura nga tatimet dhe kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore (Drejtoria Rajonale Tatimore)

Janë realizuar të ardhura nga tatimet, përfshirë të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore, me një vlerë prej 5,022,568 mijë lekë, 103 % e të ardhurave të programuara, me një tejkalim prej 156,566 mijë lekë dhe me një rritje nga viti i kaluar prej 173,044 mijë lekë dhe viti 2015 prej 686,010 mijë lekë. Megjithëse në total realizimi i të ardhurave ka pësuar rritje, krahasuar me vitin e kaluar, rritja ka ardhur nga rritja e të ardhurave nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore, pasi të ardhurat nga tatimet kanë pësuar rënie me 61,569 mijë lekë.

Programimi dhe realizimi i të ardhurave, sipas zërave për vitin 2017 dhe 2016 paraqitet:

Në mijë lekë

Nr	Lloji i të ardhurave	Viti 2017			2016	
		Plan	Fakt	%	Fakt	%
1	Tatim mbi vlerën e shtuar	295,000	340,873	116	536,302	117
2	Ttım-fitimi	364,000	406,961	112	365,085	133
3	Tatim mbi të ardh. personale	665,002	693,260	104	617,849	96
4	Taksa nacionale	42,001	43,528	104	35,189	68
5	Gjoha	0	8,234		0	0
	Totali Tatime	1,366,003	1,492,856	109	1,554,425	109
5	KONT.SIGUR.	3,499,999	3,529,712	101	3,295,099	101
	Totali	4,866,002	5,022,568	103	4,849,524	103

IV.1.c. Të ardhura Doganore

Janë realizuar të ardhura nga Dogana, me një vlerë prej 4,049,000 mijë lekë, 102 % e të ardhurave të programuara, me një tejkalim prej 67,000 mijë lekë dhe me një rritje nga viti i kaluar prej 432,000 mijë lekë.

Programimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitin 2017 dhe 2016 paraqitet:

Në mijë lekë

Nr	Emertimi	Viti 2017			2016	
		Plan	Fakt	%	Fakt	%
1	Të ardhura	3,982,000	4,049,000	102	3,617,000	87.8

Nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme janë realizuar të ardhura me një vlerë prej 59,183, me një rritje nga vitit i kaluar prej 945 mijë lekë (për vitin 2016 me

vlerë 58,238 mijë lekë) mijë lekë. Ndërsa nga ALUIZNI janë realizuar të të ardhura me vlerë 27,045 mijë lekë.

IV.2. Realizimi i Investimeve

IV.2.a. Investimet, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore

Janë kryer shpenzime për investime gjatë vitit 2017 me vlerë 1,382,984 mijë lekë nga 2,534,458 mijë lekë, ose 54.6 % e shpenzimeve të programuara, sipas njësive

Në mijë lekë

Nr.	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore	Plan	Fakt
1	Këshilli i Qarkut	40,357	2,498
2	Bashkia Shkodër	712,857	307,936
3	Bashkia Malësi e Madhe	684,224	361,183
4	Bashkia Vau i Dejës	661,558	337,987
5	Bashkia Pukë	230,231	176,084
6	Bashkia Fushë Arëz	205,231	197,296
	Shuma	2,534,458	1,382,984

Nga të cilat me fondet e buxhetit me vlerë 713,532 mijë lekë nga 990,421 mijë lekë të programuara, sipas bashkive dhe objekteve

Në mijë lekë

Nr.	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore	Plan	Fakt
1	Bashkia Shkodër	86,761	54,218
	Skema ujitëse Gur i Zi- Juban (rehabilitim)	6,155	6,052
	Blerje eskavator me zinxhir	25,402	25,402
	Skema ujitëse Berdice-Shkodër (pjesshëm)	32,710	9,096
	Skema ujitëse Gur Zi - Juban Pjesshëm	10,300	2,776
	Nd. i kanaliz. te Uj. te bardha dhe te zeza, dalja shinat e trenit	3,649	2,911
	Rikon. i pjesshem i shkolles 9-vjecare Ura e Shtrenjte Postribe	5,000	4,436
	Rikonstruksion i Godines se Teatrit "Migjeni"	3,545	3,545
2	Bashkia Malësi e Madhe	276,332	151,039
	Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare "Prek Gjoni" Bajzë (FZhR)	35,124	35,124
	Rikonstruksion i Urës tek Sheu i Suhes	7,772	7,755
	Rikonstruksion I urës në Koshnje	10,820	10,759
	Rikon. i një godine ekzistuese në Tamarë, për strehim social	9,441	
	Rikualifikim e Qendrës Bajzë Kastrati (Loti I-rë)	30,000	
	Skema ujitëse me kanalin Shtodër-Rragam, zona mbi Shkoder	15,453	14,702
	Blerje eskavator me zinxhirë	16,347	16,347
	Rehabilitim i qendrës së qytetit Koplik	83,955	
	Sistemim Aksi rrugor Bajzë-rrethrotullim	67,420	66,352
3	Bashkia Vau i Dejës	294,750	186,755
	Ndertim i vendepozitimit Bushat (faza II-të)	102,320	0

	Rikonstruksion i rrjetit ujësjes fshati melgush (faza II-të)	2,877	2,810
	Ndert i shkollës 9-vjecare “Don Martin Trushi” Stajke, Bushat	10,338	10,338
	Gjelberimi i mjediseve publike te bashkise vaudejes	87,000	87,000
	Rikualifikim i qendres se qytetit (faza I-rë)	62,215	56,607
	Rikualifikim i rruges hajmel-dheu i lehte-pistull (Loti I-rë)	30,000	30,000
4	Bashkia Pukë	147,167	136,109
	Furnizimi me uje i qytetit te Pukes rrjeti	5,072	72
	Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes së ujit	20,781	19,998
	Sistemim i lagjes pas pallatit të kulturës	13,464	10,306
	Rigjenërim i shëtitiores qëndrore	57,205	55,125
	Ndertim palestre prane shkollës "Sabah Sinani"	37,722	37,708
	Rikonstruksion shkolla e mesme "Sabah Sinani"	12,923	12,900
5	Bashkia Fushë Arëz	185,411	185,411
	Sistemim asfaltim rruge fshat Fushe Arrez, Lagjia Fushaxhi	59,294	59,294
	Ndertim i rrjetit te brendshem te ujit te pijshem dhe restaurimit te depove ekzistuese	20,781	20,781
	Rikonstruksion i fasadave dhe sheshit te Qytetit Fushe Arrez	88,836	88,836
	Blerje Zjarrfikese	4,000	4,000
	Rikonstruksion i kanalit ujites Ferrcoj-Lulaj, fshat Kryezi	12,500	12,500
	Shuma	990,421	713,532

IV.2.b. Investime në sektorin e ujit të pijshëm

Për përmirësimin e nivelit të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm me fondet nga të ardhurat e Sh.A Ujësjes dhe të bashkive, janë kryer shpenzime për investime me vlerë 24,204 mijë lekë (Në Sh.A “Ujësjes Shkodër” 10,520 mijë lekë dhe në Sh.A “Ujësjes M.Madhe 13,684 mijë lekë

IV.2.c. Investime në sektorin e energjisë elektrike

Janë kryer investime në sektorin e energjisë elektrike me vlerë 1,182,987 mijë lekë

- OShEE Sh.A, me fondet nga të ardhurat e veta, 340,894 mijë lekë
- KESh Sh.A, me fondet nga të ardhurat e veta, 842,093 mijë lekë

IV.2.d. Investimet në proces realizimi

Janë në proces realizimi, investime me vlerë 3,688,085 mijë lekë:

- Në bashkinë Malësi e Madhe me vlerë 113,955 mijë lekë, në 2 objekte, (Rehabilitim i qendrës së qytetit Koplik 83,955 mijë lekë; Rikualifikim e Qendrës Bajzë Kastrati-Loti I-rë 30,000 mijë lekë)

- Në 4 bashkitë e qarkut, investimet të cilat po kryhen nepermjet FShZh (investime, të filluara gjatë muajve Maj-Korrik 2017 dhe me afat përfundimi gjatë vitit 2018) me vlerë totale 3,574,130 mijë lekë, sipas objekteve

Nr.	Bashkia	Emertimi i objektit	Gjatesia (Km)	Vlera e kontrates me TVSh (mijë lekë)	Afati i realizimit	
					Fillimi	Përfundimi (muaj)
1	Shkoder	Rikonstruksion i rruges Shkoder Velipoje segmenti Harku i Berdices - Baks (Lot I-rë, II-të dhe III-të)	18.52	2,297,145	Qershor-Korrik 2017	18
2	Vau Dejes	Rikonstruksion i unazes qyteti Vau Dejes	1.8	178,960	Maj 2017	10
3	Pukë	Rikualifikim i qendrës dhe liqenit të vogël në Pukë		173,522	Qershor 2017	10.5
4	Fushë Arëz	Rikonstruksion (Rehabilitim dhe veshje me asfalt) i rrugës F.Arëz (K/Hadrojit)-Reps (Rotonda)		924,503	Qershor 2017	16

Në sektorin e energjisë

Me fondet nga të ardhurat e veta nga ana e KESH Sh.A

Nr.	Objekti/projekti	Vlera e kontrates me TVSh (mijë €)	Afati i realizimit	
			Fillim (viti)	Përfundimi (viti)
1	Rahabilitim me rinovim teknologjik të kuzhineteve mbështetëse të 5 agregatëve, HEC V.Dejës (3,545,062/vit për 3 vite)	10,635	2017	2019

V. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT ME ADMINISTRATËN E SHTETIT (Administratën Qendrore, Ministrinë, Institucionet qendrore në nivel vendor)

Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkoder në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësisë ka shqyrtuar veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor dhe ka bashkërenduar punën ndërmjet tyre, për realizimin e detyrave në përputhje me programin e qeverisë; Ka intensifikuar punën lidhur me bashkëpunimin me institucionet qendrore në nivel vendor, me njësitë e veteverisjes vendore, organizatat dhe shoqatat e ndryshme që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të Qarkut, nëpërmjet takimeve të shumta me drejtues të ministrive e Institucioneve të tjera qendrore, me qëllim zgjidhjen e problemeve që janë konstatuar nga institucionet në nivel Qarku.

Gjatë vitit rëndësi i është kushtuar zbatimit të VKM-së nr.253, dt 6.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi

për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave” dhe VKM nr.222, dt 6.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, proces për të cilin janë organizuar takime me drejtues të njësive të vetëqeverisjes vendore (bashkive dhe Njësive Administrative), përfaqësues të Komisionit Qeveristar të Tokës, të Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme.

Prefekti ka patur bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet qendrore, Degët Territoriale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke koordinuar edhe veprimtaritë e tyre në nivel qarku, lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e turizmit,

V.1. Institucionet qendrore në nivel vendor dhe veprimtaria e tyre

V.1.1. Drejtoria Rajonale e Tatimeve

Janë realizuar të ardhura nga tatimet, përfshirë të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore, me një vlerë prej 5,022568 mijëe lekë, 103 % e të ardhurave të programuara, me një tejkalim prej 156,566 mijë lekë dhe me një rritje, nga viti i kaluar prej 173,044 mijë lekë dhe nga viti 2015 prej 686,010 mijë lekë. Megjithëse në total realizimi i të ardhurave ka pësuar rritje, krahasuar me vitin e kaluara, rritja ka ardhur nga rritja e të ardhurave nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore, pasi të ardhurat nga tatimet kanë pësuar rënie krahasuar me vitin 2016 me 61,569 mijë lekë

Gjatë vitit ushtrojnë aktivitetin e tyre 6,307 subjekte, me një numër prej 31,453 punonjësish (kontribuesish), nga të cilët: Shkodër 5,540 subjekte me 27,293 punonjës; Malësi e Madhe 461 subjekte me 2,211 punonjës dhe Pukë 306 subjekte me 1,949 punonjës

Numri i të punësuarve në total gjatë vitit 2017 ka pësuar rritje krahasuar me vitin e kaluar me 655 vetë

Sipas të dhënave të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, për kontribuesit, numri i të punësuarve për vitin 2016 dhe 2017 paraqitet:

Nr.	Emërtimi (sipas sektorëve dhe statusit)	Numri i të punësuarve, sipas vitit	
		2017	2016
1	Në sektorin publik	9,933	9,764
	a. buxhetor	9,478	9,295
	b. jobuxhetor	455	469
2	Në sektorin privat	21,520	21,034
	a. Subjekte të regj. si person fizik	8,028	7,678
	b. Subjekte të regj. si person juridik	13,492	13,356
	Nga të cilët:		
	- Vendase	11,395	11,103
	- Të përbashkëta	625	665
	- Të huaja	1,472	1,588
	Gjithsej	31,453	30,798

Të ardhurat e realizuara, numri i subjekteve të regjistruara i cili ka pësuar rritje, numri i të punësuarve (kontribuesve), i cili ka pësuar rritje krahasuar me vitin e kaluar, tregojnë jo

vetëm për masat e marra ndaj informalitetit, por janë tregues të përmirësimit të punës e performances së Drejtorisë Rajonale të Tatimeve

V.1.2. Drejtoria e hetimit tatimor (Rajoni Verior)

Gjate vitit ka referuar ne Prokurori 45 subjekte tregtare per vepra te ndryshme penale ne fushen e tatimeve dhe taksave, ose 26 referime me shume se ne 2016. Jane propozuar per kontroll te thelluar 19 subjekte tregtare. Për shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit dhe virifikimit në terren ne terren rreth 6500 subjekte tregtare; Janë marrë masa administrative, penalitete në 1383 raste me vlere 60 770 mijë lekë; Jane mbyllur 111 subjekte pa license; Ështe ndryshuar pergjegjesia tatimore per 47 subjekte tregtare; jane bllokuar 7 subjekte tregtare per “Mos leshim kuponi, hera dyte”. Problem per Drejtorine e Hetimit Tatimor, Rajoni i Veriut, është mungesa e ambienteve për ushtrimin e veprimtarisë (Aktualisht për zhvillimin e veprimtarisë Drejtoria me një 53 punonjës, sipas organikes, ka në dispozicion vetëm 6 zyra të vogla).

V.1.3. Dega e Doganës Shkodër

Janë realizuar të ardhura me vlerë 4,049,000 mijë lekë, nga 3,982,000 mijë lekë të programuara, ose 102 %, me një tejkalim prej 67,000 mijë lekë, me një rritje nga viti i kaluar prej 432,000 mijë lekë (nga 4,110,227 mijë lekë të programuara)

Nepermjet implementimit të metodave të reja dhe teknologjisë është mundësuar ofrimi i procedurave të shpejta dhe korrekte doganore, duke nxitur kështu tregtinë e lirë.

Si rezultat i bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe strukturat e policisë vendore është intensifikuar puna, për goditjen e fenomenit të fshehjes së detyrimeve doganore nga subjektet gjatë importit të mallrave, bashkëpunim i cili është reflektuar në treguesin e relizimit të të ardhurave.

V.1.4. Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të ushqimit

Puna e Drejtorisë është përqendruar e realizimin e planeve të Inspektiveve të miratuara nga DPAKU; Ne realizimin e detyrimeve të planifikuara të treguesve financiar; Ne zbatimin me rigorozitet të praktikave sipas ligjit. Për gjetjet e konstatuara gjatë ushtrimit të 2116 kontrolleve dhe inspektiveve, janë marrë masa administrative e disiplinore në 168 raste, nga të cilat gobë në 48 raste me vlerë 5,225 mijë lekë; 102 masa administrative “Paralajmerime”, për rregullimin e mangesive të konstatuara, si dhe 18 raste ndërprerje të veprimtarisë së subjekteve. Janë analizuar 1345 mostra nga laborator rajonal zyrtar, si dhe janë kryer 2786 analiza për produkte vendi dhe importi.

V.1.5. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore

Me sistemimin e të gjithë rregjistrave dhe borderove të terhequra nga arkivi vendor qendror, si dhe me hedhjen e listpagesave, të subjekteve publike e private dhe të dhënave të regjistrave të grumbulluar, është mundësuar zgjidhja e shpejtë e kërkesave të shtatasve, për vjetërsinë në punë, përfitim pensioni, etj.

V.1.6. Drejtoria e Rajonale e Shërbimit Kombëtar të punësimit

Në fund të vitit janë regjistruar punëkërkes të papunë 7055 persona (ku 49 % e punëkërkesve të pa punë janë femra) nga 7920 persona të regjistruar në fund të vitit të kaluar, me një diferencë më pak 865 persona, ose rreth 11 %. Rënie ka pësuar edhe numri i punëkërkesve të papunë që trajtoheshin në skemat e mbështetjes me të ardhura nga buxheti i shtetit: ndihmë/ ekonomike dhe pagesë papunësie. Në fund vitit, në këtë skemë trajtohen gjithsej 4060 pu.pa., ndërkohë që në fund të vitit të kaluar në këtë skemë trajtoheshin 4501, me një diferencë më pak 441 pu.pa., ose 9.8% më i ulët.

Gjatë vitit 2017 janë kryer 7 454 kontakte me punëdhënësit në qark, ose 17 % më teper krahasuar me vitin e kaluar, nga të cilat 4148, ose 55.6% në Zyrën e punësimit dhe 3 306, ose 44.4 % në ndërmarrje (802 kontakte në ndërmarrje, ose 24.2% e janë vizita të reja).

Është rritur oferta për punë krahasuar me vitin e kaluar me 179 vende, ose 6.6 % (2690 vende nga 2511 që ka qenë vitin e kaluar). Niveli i plotësimit të ofertave është 2318, ose në masën 86 %

Punësime të pu.pa., nga 1680 plani i ardhur nga SHKP, është realizuar në masën 1881, ose 112% . Por nga plani 470 punësime me programe të nxitjes së punësimit, faktikisht ka ardhur fond për 352 pjesëmarrës, pra punësimi me nxitje është realizuar në masën 74.9% të planit vjetor). Ndërsa ndërmjetësimet për punë janë realizuar 900 (së bashku me nxitjen) ose në masën 82 % të totalit të planit vjetor. Në mos realizimin e planit të ndërmjetësimeve deri tani, ka patur ndikim të madh si struktura e vendeve të lira të shpallura, ashtu edhe struktura e pu.pa.-ve sipas moshës dhe kualifikimit. Gjatë këtij viti mbi 75 % e ofertave të punës kanë qënë nga fasoni dhe telemarketingu, në një kohë që struktura e pu.pa. ka qënë në pjesën më të madhe të këtij viti rreth të femrave janë të grup-moshave mbi 40 vjeç për rajonin dhe 61.3 % për Shkodrën, jashtë kërkesave të tregut të punës.

Punësimi vazhdon të paraqesë vështirësi, pasi pesha që zë fasoni (rrobaqepsi, këpuctari dhe përpunim peshku) në strukturën e biznesit, duke qënë se në këtë sektor kërkohen vetëm gra e vajza , duke mbetur në kuota pothuajse minimale ofertat e punës për punëkërkesit e papunë meshkuj.

Janë të depozituara në drejtorinë tonë gjithsej 45 kontrata kolektive si Rajon me numër punonjeshish 4019 , nga ku: nga sektori publik 17 kontrata me 1582 punonjës dhe nga sektori privat 28 me 2437, numri i punonjësve. Sipas përfaqsimit është kjo situatë: 23 kontrata përfaqësuar nga KSSH , 20 kontrata nga BSPSH dhe 2 kontrata të përbashkëta BSPSH dhe KSSH.

Janë të depozituara në Shkodër gjithsej 27 kontrata kolektive me numër punonjeshish 3572 , nga ku: nga sektori publik 6 kontrata me 1321 punonjës dhe nga sektori privat 21 me numër punonjeshish 2251. Sipas përfaqsimit është kjo situatë: 19 kontrata përfaqësuar nga KSSH , 6 kontrata nga BSPSH dhe 2 kontrata të përbashkëta BSPSH dhe KSSH.

Nga punëkërkesit e pa punë janë regjistruar dhe trajnuar në kurse formimi publik e jo publik 451 persona. Nga Bashkëpunimi me DRFPP-në, kurse të profesionit në këtë Qëndër, **413** -pu.pa të rregjistruar në 19 lloje kursesh (Hidraulik 38, Panele diellore 43, elektrikist 9, sekretari arkiv 25, riparim elektroshtëpiake 6, Rrobaqepësi 26, parukeri 81, Receptionist 26, Mekanik 21, Instalim kaldajash 25, Kaldaist 5, Berber 18, Mobilier 12, Kuzhinier 43,

Kamaier 5 dhe Manikyr - Pedikyr 4) nga të cilët :159–janë femra. Ndërsa në formimin jo publik janë regjistruar e kanë përfunduar kursin 38 punëkerkues të papunë.

Gjatë vitit janë çertifikuar në kurse 295 persona, ose 65.4 % e të trajnuarve. Treguesi i monitorueshëm “I punësimit pas një kursi profesioni“ është realizuar në masën 83.7 % e planit vjetor (nga 110 sipas planit janë punësuar 92 persona: elektrikist 6; qepës tekstilësh 16; hidraulik 5; mekanik makina qepëse e automjetesh 10; qepëse lëkurës 12, kamerier, banakier, etj.)

Në fund të vitit ka patur 478 vende të lira pune, sipas sektorëve:

- i. fasoneri dhe përp.peshku rreth 213 (kryesisht femra dhe pa profesion)
- ii. kepucëve 100
- iii. forcat e armatosura rreth 30
- iv. të tjera 135

V.1.7. Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Sherbimeve Shoqërore

Jane inspektuar 403 subjekte (nga të cilët për herë të parë 135 subjekte) me nje numer total 6801 punemarresish, nga ku per shkelje te legjislacionit te punes dhe kushteve te shendetit dhe sigurise ne pune, jane marrë masa në 21 raste (gjobe 4 subjekte me vlerë 900 mijë lekë dhe me paralajmërim 17 subjekte me 1165 punonjës). Po kështu jane futur ne skemen e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore 41 punemarres te pasiguruar, të evidentuar gjatë inspektimit. Ka patur 13 ankesa nga punemarres te ndryshem, te cilet jane ankuar kryesisht per mos zbatim te kushteve te kontrates se punes, mos dhenie te pages, dhe pushim te padrejte nga puna. Ka patur 3 aksidente ne pune. Ështe bere monitorimi i 24 subjekteve me aktivitet ne fushen e tregtimit te karburanteve dhe SHPSF

V.1.8. Drejtoria e Bujqesise

Jane vleresuar 210 projekte në skema mbështetëse nga te cilat 104 projekte Bujqesore dhe 106 projekte blegtorale, me një vlerë prej 55,277 mijë lekë, për të cilat janë kryer verifikime dhe kontrole të përdorimit të subvencioneve

Drejtoria e Bujqesise ne bashkepunim me Programin SARED per informimin e fermerëve me kriteret dhe kushtet e perfitimit ka realizuar 22 aktivitete.

Disa problematika te hasura jane shumica e aplikanteve penalizohen nga dokumenti i pronesise mbi token, zonat malore te Shkodres, Malesi e Madhe dhe Puke nuk kane dokumenta pronesie, pasi shumica e fermerëve jane ne kufijte e vjeter te pronesise se tokes; Vonesat e medha ne dhenien e vertetimeve te shlyerjev te energjise elektrike nga OSHEE; Sigurimet shoqerore te jene gjithepershiresë te pranohen sigurimet individuale si fermer te mos i hiqet e drejta per aplikim te atyre qe jane te siguruar nga nje punedhenes tjeter; Sigurimi te jete për vitin në të cilin aplikohet nga fermeri, pasi për mungesë të ardhurash për shlyrjen e detyrimit (derdhjen e kontributit për vitin e kaluar) mbetet pa aplikuar. Në periudhën e rreshjeve të fund vitit 30 Nentor-2 Dhjetor ka patur përmbetje në një sip. prej 190 Ha, kryesisht në Nj.A Ana e Malit

V.1.9. Drejtoria e ujitjes dhe kullimit Lezhë

Në ushtrimin e veprimtarisë ka koordinuar punën me njësitë e vetëqeverisjes për pastrimin e rrjetit të kanaleve ujitëse e kulluese, sidomos të rrjetit kullues për menaxhimin sa më të mirë të situatës në kohë rreshjesh dhe në ato njësi e zona ku ka patur probleme vitet e kaluara. Pas konstatimit te eurozion ne brigjet e lumit Buna ne afersi te Darragjatit, Bashkia

Shkoder është nderhyre me investime ne mbrojtjen e bregut dhe frenimin e erozionit ne ate zone.

V.1.10. Agjensia e Basenit Ujor Drin-Bune

Gajtë vitit jane zhvilluar tre mbledhje te Keshillit te Basenit Ujor Drin-Bune, në të cilat janë marrë 90 vendime, nga 103 projekt vendime të paraqitura.

Jane ushtruar 106 kontrole. Nga 234 kerkesa të paraqitur nga subjektet, per tu pajisur me leje ose autorizim te perdorimit te burimit ujor, jane dhene 80 leje dhe autorizime per perdorim te burimit ujor, të cilave u janë vendosur vendosur ujë matësit. Ka patur bashkepunim të mirë me ISHU, ne lidhje me evidentimin e subjekteve qe perdorin burime ujore pa leje.

Faturimi i subjekteve perdorues bazohet ne leximin e matesave, dhe nga te dhenat e derguara nga OSHEE per hidrocentrale.

Ujesjelles kanalizime Sh.A Shkoder faturohet nga vetëdeklarimet e bera, pasi DPUK dhe ERU kane refuzuar dergimin e te dhenave. Ujesjellesit e tjere nen administrimin e ABU Drin-Bune nuk dergojne te dhena .Problem ka qenë mungesa e vulave per ujëmatësit

V.1.11. Dega Rajonale e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave

Dega Rajonale e ISHMPU, ka kryer gjithsej 1 155 inspektime te ndara ne 402 inspektime ne fushen e mbrojtjes se mjedisit dhe kontrollin e subjekteve dhe 753 inspektime ne fushen e mbrojtjes se Pyjeve, faunes, flores dhe nderhyrjet ne parandalimin e shuarjen e zjarreve, ka evidentuar rreth 370 hotspotet per te cilat ka filluar puna per pastrimin e tyre; jane marre gjithsej 26 vendime per denim administrativ (gjobe) nga te cilat 12 jane vendosur nga sektori i Inspektimit ne Mjedis per shkelje te dokumentacionit mjedisor, 14 jane marre per shkelje ne fondin pyjor, ne flore dhe faunen e eger.

V.1.12 Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik

Nga 1100 persona të planifikuar për tu regjistruar në kurset e formimit profesional janë regjistruar 1106 persona (në 19 kurse të ndryshme profesionale dhe komplementare), nga të cilët janë çertifikuar 884 dhe janë në proces 222 persona

Në realizimin e objektivave vjetore për formim profesional në përshtatje me kërkesat dhe nevojat e tregut rajonal të punës, gjatë këtij viti nuk ka patur probleme për tu veçuar, duke përjashtuar rastin e nevojave për investime, në funksion të përmirësimit dhe shtimit të laboratoreve të Qendrës.

Bashkëpunimi me institucionet qendrore në nivel vendor, veçanërisht me Zyrat e Punësimit Shkodër, Malësi e Madhe, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Inspektoriatin Shtetëror të Punës, si dhe Zyrën e Shërbimit Social pranë Bashkisë, Shkodër etj. ka qenë efektiv. Prioritet i veçantë ka qenë dhe mbetet bashkëpunimi me bizneset. Është bashkëpunuar edhe me subjekte të tjera, të cilat ofrojnë arsim dhe formim profesional. Bashkëpunim të veçant ka patur edhe me OJF të cilat kërkojnë, ofrojnë dhe mundësojnë shërbime në funksion të formimit profesional për personat që i përkasin shtresave vulnerabël.

V.1.13. Arsimi

Gjatë vitit me fondet e buxhetit dhe të bashkive është bërë përmirësimi i infrastrukturës (ndërtim e rikonstruksion në 10 shkolla; Në bashkinë Malësi e Madhe, Rikonstruksion Shkollës 9-vjeçare “Prek Gjoni” Bajzë dhe Rikonstruksion i shkollës Xhaj; Në bashkinë Shkodër, Rikonstruksion i shkollës “T.Smajli”, Rikonstruksion i shkollës mesme “Oso Kuka”, Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Ura e Shtrenjtë” Postribë, Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare “Dëshmorët e Prishtinës”; Në bashkinë Vau i Dejës, Ndërtim i shkollës 9-vjeçare “Dom Martin Trushi” Stajkë-Bushat, Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Toplanë; Në bashkinë Pukë, Rikonstruksion i shkollës mesme “Sabah Sinani” dhe ndërtim palestre pranë shkollës mesme “S.Sinani”)

Janë përmirësuar kushtet për zhvillimin e një procesi normal mësimor, me krijimin e laboratorëve të informatikes dhe sigurimin e internetit në të gjitha shkollat. Janë krijuar struktura mbështetëse për zhvillimin e mësimin nxënësve me aftësi ndryshe (Janë caktuar mësues mbështetës për zhvillimin normal të procesit mësimor të nxënësve me aftësi ndryshe)

Nuk ka nxënës, të cilët nuk frekuentojnë mësimin për shkak të fenomenit të gjakmarrjes (vitin e kaluar ka patur 5 nxënës). Personeli mësimor është me arsimin përkatës, sipas profilit të mësimdhënies

Gjatë vitit arsimor 2017-2018 janë ulur për herë të parë në bankat e shkollës (në klasën e I-rë) 1800 nxënës. Ka rënie të numrit të nxënësve të cilët janë regjistruar e vazhdojnë shkollën, krahasuar me vitin e kaluar (megjithëse janë regjistruar edhe 400-500 nxënës të familjeve të kthyer nga emigracioni), që ka ardhur jo vetëm nga lëvizja e popullsisë, por edhe nga rënia e numrit të lindjeve.

Për shkak të ngarkesës procesi mësimor në 10 shkolla zhvillohet me 2 turne (Në bashkinë Shkodër në 9 shkolla; Shkolla “I.Qemali”, “N.Mjeda”, “I.S.Briçaj”, “T.Smajli”, Shtoj Ri, “Xh.Fishat”, “Isa Jakupi”, “B.Kadia”, “Nikoll Zagorjani” dhe në bashkinë Malësi e Madhe në shkollën “V.Shanto” Vrakë). Po kështu për shkak të rikonstruksionit të shkollës mesme “Sh Hoxha” Koplik, mësimi zhvillohet me 2 turne në shkollën 9-vjeçare “A.Bajraktari” Koplik.

Ambientet në të cilat zhvillohet mësimi, për shkak të amortizimit të ndërtesave, nuk janë të përshtatshme dhe brenda kushteve për zhvillimin normal të procesit mësimor, kështu që kërkohet marrja e masave për përmirësimin e gjendjes së tyre, nepermjet rikonstruksionit në Në bashkinë Shkodër 5 Shkolla (Shkolla e mesme e bashkuar në Dajç, Shkolla e mesme e bashkuar Postribë, shkollat 9-vjeçare Shtoj Ri, Shtoj i Vjeter dhe “Skenderbej”); Në bashkinë Malësi e Madhe 3 shkolla (Shkolla 9-vjeçare Bratosh e Vukpalaj dhe shkolla CU Kurte); Në bashkinë Pukë shkolla 9-vjeçare “Migjeni” së bashku me palestren e kësaj shkolle; Në bashkinë Fushë Arëz 2 shkolla (Shkolla e mesme e bashkuar Iballë dhe shkolla 9-vjeçare Fierzë)

V.1.14. Drejtoria Rajonale e Kultures Kombetare Shkoder

Si rezultat i masave të marra, përfshirë edhe vendosjen e sistemit të biletarise elektronike në kalane e Shkodres (investim ky nga AADF-Fondi Shqiptaro Amerikan i Zhvillimit dhe Ministrise se Kultures), janë rritur të ardhurat nga shitja e biletave.Numri i vizitorëve krahasuar me vitin e kaluar është rritur me 10 mijë Jane hartuar dhe zbatuar projekte në konservim dhe restaurim monumentesh në kalane e Shkodres

V.2. Problemet e rendit dhe të sigurisë, rekomandime për përmirësimin e punës në vazhdim

Gjatë vitit krahasuar me vitin e kaluar 2016 kriminaliteti është ulur në masën 13.1 %, ose me 347 vepra penale më pak (Nga 2655 vepra penale të evidentuara gjatë vitit 2016 në vitin 2017 janë evidentuar 2306)

Evidentimi dhe referimi në prokurori i veprave penale, si dhe zbulueshmëria e tyre për vitin 2017 e 2016, sipas të dhënave të Drejtorisë Vendore të Policisë, paraqitet:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Viti	
			2017	2016
1	Vepra penale të evidentuara dhe të referuar në prokurori	Numër	2306	2655
2	Vepra penale për të cilat janë zbuluar autorët	“	2016	1950
3	Persona të implikuar,	“	2520	2455
	Nga të cilët			
	-U është privuar liria (arrestuar)	“	723	842
	-Janë ndaluar	“	218	256
	-Janë ndjekur në gjëndje të lirë	“	1370	1170
	-Janë shpallur në kërkim, pasi janë larguar, apo i fshihen drejtësisë	“	202	181
	-Kanë ndërruar jetë (në rrethana të vërtetuar proceduralisht)	“	7	6

Gjatë vitit nga shërbimet policore janë evidentuar dhe referuar në prokurori 2306 vepra penale. Nën drejtimin e prokurorive të rretheve gjyqësore nga veprimtaria hetimore-gjurmuese shërbimet policore kanë arritur të mbledhin fakte dhe prova, duke zbuluar e dokumentuar autorësinë e 2016 veprave penale, me një zbulueshmëri 87.4 % nga 73.4 % që ka qenë vitin e kaluar.

Nga Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit gjatë vitit vëmendjen e ka përqendruar në drejtim të kontrollit të kufirit, parandalimin dhe goditjen e aktiviteteve të kundraligjshme që mund të zhvillohen nepermjet kufirit shtetëror, menaxhimin e fluksit të levizjeve të shtetasve dhe mjeteve nepermjet pikave të kalimit kufitar si dhe sigurimin e rendit dhe qetesise publike gjatë sezonit turistik 2017. Prioritet ka qenë goditja e trafikut të narkotikeve, kalimi i pa ligjshëm i kufirit, peshkim i nadaluar dhe fallsifikim i dokumentave. Gjatë vitit janë evidentuar 95 vepra penale, të cilat i janë referuar prokurorisë

Në menyrë të veçantë, gjatë sezonit turistik, është bërë një punë shumë e mirë nga të gjitha shërbimet e Policisë Kufitare të DVKM-së Shkodër mbi marrjen e masave organizative “Për garantimin e rendit dhe sigurisë publike në zona turistike dhe plazhe, rritjen e parametrave të sigurisë rrugore dhe menaxhimin e hyrje/daljeve në kufi, pasi gjatë sezonit turistik veror 2017 ka patur një fluks të madh levizjesh shtetasish e mjeteve. Është marrë takim me drejtuesit e Agjensive Turistike që shtrijnë veprimtarinë e tyre nëpërmjet pikave të kalimit në juridiksionin e DVK&M Shkodër, me qëllim shkëmbimin e informacioneve për regjimin e hyrje/daljeve të shtetasve të huaj dhe shqiptar, duke ju bërë të ditur detyrimin që kanë shoqëritë turistike për njoftimin në adresën elektronike të DVKM-së për dërgimin e listës së udhëtarëve me qëllim kryerjen e procedurave të përshpejtuara gjatë sezonit turistik veror 2017. Është bashkëpunuar me organet doganore për përmirësimin e infrastrukturës në

PKK, për vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale, vijëzimin e rrugëve dhe ndriçimin e novojshëm, për të orjentuar levizjen e sigurtë të turistëve, nga hyrja deri në dalje të P.K.K-ve. Po kështu gjatë gjithë periudhës së sezonit turistik janë kryer shërbime suplementare me qëllim menaxhimin sa më të mirë të sezonit turistik. Gjatë sezonit nuk ka pasur asnjë incident të krijuar nga mjetet mororrike të ujit, u është dhënë ndihmë pushuesve në 82 raste me 143 shtetas, janë vendosur 19 masa administrative, Ggobë me vlerë 190 mijë lekë, janë bllokuar administrativisht 3 mjete lundruese

Për menaxhimin sa më mirë të fluksit të lëvizjes së hyrje-daljeve të shtetasve dhe mjeteve, kryerjen e shërbimit pa krijuar radhë të gjata, në P.K.K Muriqan e Hani i Hotit dhe Bashkim, janë shtuar postet e punës, respektivisht 3, 2 dhe 1 post (Gjatë vitit krahasuar me vitin e kaluar ka patur një rritje të perpunimit të shtetasve me 513867 ose 16.7% dhe të automjeteve 174997, ose 15.4% .

Rekomandime për përmirësimin e punës

1. Rritja e bashkëpunimit dhe e koordinimit mes të gjithë aktorëve, marrëdhëniet direkte me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet qendrore në nivel vendor (pasi me shtrirjet e mëdha territoriale të bashkive, mundësitë e fenomeneve të kriminalitetit janë më të mëdha), duke krijuar struktura (grupe) të veçanta bashkëpunimi, për shërbimet e ndërsjellta të policisë vendore, policisë bashkiake dhe institucioneve qendrore në nivel vendor (duke analizuar periodikisht nivelin e bashkëpunimit dhe rezultatet e arritura) për:

a. Parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike si dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të përdoruesve të tyre, ku kërkohet një bashkëpunim më intensiv me administratorët e njësive administrative, të lagjeve dhe kryetarët e fshatrave për evidentimin, njohjen dhe identifikimin e jo vetëm të zonave dhe sipërfaqeve tashme të njohura të kultivimit të bimëve narkotike por edhe të personave tashme të skeduar nga policia, të cilët duhet të jene edhe në siten e skanimit të drejtuesve të të gjitha niveleve

- Në luftën kundër përhapjes së bimëve narkotike, parësore mbetet puna parandaluese në kultivimin e tyre dhe për të cilën duhet një mbikëqyrje e rreptë dhe e vazhdueshme në

• Menaxhimin e burimeve njerëzore, që merret me aktivitetin e paligjshëm të bimëve narkotike, sipas periudhave (Në periudhën përgatitore dhe kultivimit, që nga punimi dhe përgatitja e sipërfaqeve për mbjellje; lëvizja e farave dhe fidanëve e cila kryhet nga zonat urbane në ato rurale; tregtarët, transportuesit dhe personat e tjerë potencial për tu marrë me këtë aktivitet të paligjshëm) dhe njësive administrative e fshatrave (Ato Nj.A, fshatra, zona dhe sipërfaqet të cilat janë të njohura për kultivimin apo mundësinë e kultivimit të bimëve narkotike)

b. Përmirësimin e sinjalistikës rrugore dhe disiplinimin e trafikut rrugor, nëpërmjet shërbimeve të përbashkëta të struktura të policisë me ato të institucioneve përgjegjëse e të njësive të vetëqeverisjes vendore.

c. Hartimin e planeve të përbashkëta operacionale dhe shkëmbimin e informacioneve të ndërsjellta për parandalimin, ndërhyrjen dhe menaxhimin e situatave të emergjente.

d. Hartimin e planeve të përbashkëta, në zbatimin e masave për ruajtjen e rendit dhe sigurisë gjatë zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme (kulturore, sportive, etj), tubimeve, apo në raste festash kombëtare e lokale.

e. Hartimin e planeve të përbashkëta dhe mbështetjen e njësive të vetëqeverisjes vendore, Degëve Territoriale, operatorëve turistik, etj. në marrjen e masave për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik

2. Bashkëpunimi me institucionet arsimore (Drejtorinë Rajonale, zyrat arsimore, shkollat e sistemit parauniversitar dhe universitetin) për parandalimin e përdorimit të lëndëve narkotike jo vetëm në ambientet e shkollave dhe universitetit, por as jashtë këtyre ambienteve nga nxënësit dhe studentët, duke qenë kontingjenti më i mundshëm.

3. Bashkëpunimi me institucionet e kultit, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe organet e drejtësisë, për evidentimin e personave me tendencë terroriste, apo propaganduese e bashkëpunuese me strukturat e ISIS

V.3. Problemet e konstatuara nga analizat mujore të punës të institucioneve qendrore në nivel vendor

Nga analizat e veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor, janë konstatuar:

- Problemet e pronësisë mbi tokën bujqësore, e cila veç të tjerave ka sjellë edhe pamundësinë e përfitimit të financimit të fermerëve, nga ana e buxhetit (subvencionimi në kultura bujqësore, ose lloje të gjësë së gjallë)

- Menaxhimi i mbetjeve mbetet akoma problem dhe nje sfide vecanerisht per zonen periferike te qyteteve, perfshi njesite administrative Rrethina, Postribe, Ana e Malit, Gruemire, Guri Zi, etj. Megjithe masat dhe permiresimin e sherbimit, akoma mbeturinat digjen ne zona te caktuara dhe bile edhe brenda kontinjerve (kazaneve) duke u bere shkak i rritjes se semundshmerise se qytetarve me ndotjen e mjedisit.

- Informaliteti në sektorin e ujit të pijshëm (Lidhjet e paligjshme, mungesa e kontratave në kryerjen e shërbimit, përdorimi i ujit të pijshëm për ujitje, humbjet e shpërdorimet)

- Mungesë bashkëpunimi i AKUK me Agjencën e Basenit “Drin-Bunë” për dërgim të dhënash, lidhur me sasitë e përdorimit të ujit nga Sh.A Ujësjellës, sipas bashkive

- Përmirësimi i nivelit të shërbimit të furnizimit me energji elektrike, në menyrë të veçantë i zonave të thella malore gjatë periudhës së dimrit, duke përfshirë edhe lidhjen me sistemin e furnizimit të Njësive Administrative të Dukagjinit, të cilat furnizohen nepermjet HEC Ndërlësë

V.4. Grupet e punës ndërinstitucionale (task-forcat)

Prefekti i qarkut ka drejtuar grupet ndërinstitucionale (task forcen vendore), duke qenë pjesë përbërëse e tyre, për:

- Koordinimin dhe bashkëveprimin efektiv të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të këtyre Institucioneve me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kontrollin efikas të territorit me qëllim parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit, si dhe monitorimin dhe kontrollin e veprimtarisë së strukturave dhe institucioneve të ngarkuara për zbatimin e Planit të Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit

- Çështjet e luftës kundër trafikimit të personave

- Monitorimin e veprimtarisë së therjes së kafshëve dhe transportit e tregtimit të mishit, si dhe marrjen e masave parandaluese për ushtrimin e aktivitetit në kundërshtim me legjislacionin që rregullon zhvillimin e këtij aktiviteti

- Monitorimin dhe kontrollin e masave, për zbatimin e detyrimeve ligjore për sigurinë në plazhe
- Monitorimin e zbatimit të plan veprimit të miratuar “Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2017”
- Kontrollin dhe monitorimin e menaxhimit të mbetjeve, brenda territorit të qarkut, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore
- Identifikimin e Nevojave për Reabilitimin e Shtretërve të Lumenjëve
- Marrjen e masave emergjente mbrojtëse për parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim në pyje publike e private (Bashkëpunim për ngritjen e grupeve të përbashkëta të patrullimit në postblloqe fikse si dhe ato të lëvizshme për parandalimin dhe ndëshkimit të rasteve të transportit të kundërligjshëm të lendes drusore e deri në kontrollet e befasishme dhe të programuara ndër zona pyjore me problematike për dëme në fondin pyjor, Bashkëpunim i cila ka dhënë rezultatet e veta pozitive, për disiplinimin dhe venien nën kontroll të prerjeve abuzive të druveve pyjore dhe transportit të paligjshëm të tyre, në zbatim të VKM nr 348 për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit pyjeve dhe të shitjes së lendes drusore për furnizimin e popullatës me dru zjarri, duke mbajtur nën kontroll të vazhdueshëm disa nga zonat pyjore me problematike, siç janë Shllak-Cukal, Brucaj-Sume, Razem-Fushe e Zeze, Terbun-Munelle e Qaf Mali, bashkive të Qarkut Shkoder si; Shkoder, Vaudejes, Puke, Fushe Arrez e Malesise e Madhe. Po kështu janë marrë masa për mbrojtjen nga gjuetia e paligjshme, duke përqendruar vëmendjen për zonat e Mbrojtura (Liqenit të Shkodrës, Lumi Buna dhe Rezervat-Velipoje)

V.4.1.Task Forca Vendore Antikanabis

Në zbatim të Planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020 (Miratuar me VKM Nr. 248, datë 29.03.2017), me përfaqësues të Degëve Territoriale të të gjitha Institucioneve që janë të përfaqësuara në TFQ, si dhe përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore (mbi bazën e marrëveshjeve të bashkëpunimit) është ngritur Task Forca Vendore “Për realizimin e koordinimit dhe bashkëveprimit efektiv të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të këtyre institucioneve me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit”, është ngritur nga Prefekti i Qarkut (Urdhër Nr. 15, datë 10.04.2017)

Nga ana e Prefektit, në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësive, në cilësinë edhe të drejtuesit të Task Forcës Vendore janë organizuar 4 takime të Task Forcës Vendore (10.04; 26.05; 03.08 dhe 21.09), takime në të cilat kanë marrë pjesë drejtues të institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore, ku janë analizuar puna dhe arritjet sipas institucioneve dhe njësive dhe në nivel qarku, dhënë rkomandimet përkatëse:

- rritjen e nivelit të bashkëpunimit në mes të të gjitha institucioneve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për zbatimin e planit të masave, të përcaktuara nga vetë këto institucione e njësi, në kuadër të planit të veprimit antikanabis 2017-2020
- dokumentimin e saktë të veprimtarisë të të gjitha strukturave, në mënyrë të veçantë i verifikimeve qoftë nga institucionet apo njësitë e vetëqeverisjes vendore, apo me grupe të përbashkëta, duke shmangur mungesën e përgjegjësive

- komunikimin institucional dhe shkëmbimi i informacionit në mes institucioneve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, në kohë, lidhur me verifikimet e kryera dhe gjetjet nga verifikimet.

- adresimin e saktë të informacioneve, duke shmangur informacionet e përgjithshme të cilat nuk i shërbejnë punës (siç është informacioni i drejtuesve të bashkisë Vau i Dejës, për dyshime se në sipërfaqet e zona të fshatrave të Nj. A është mbjellë kanabis).

Po kështu nga Prefekti i qarkut në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore, janë organizuar takime në të 5 bashkitë e qarkut (Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Puke dhe Fushë Arëz), lidhur me marrjen e masave antikanabis, takime në të cilat është kërkuar rritja e përgjegjësisë në përmbushjen e detyrimeve ligjore antikanabis.

Nga ana e strukturave të policisë në qarkun Shkodër janë zhvilluar 132 takime sensibilizuese, në të cilat kanë marrë pjesë 3175 persona, të cilat kanë patur qëllim ndërgjegjësimin e publikut në parandalimin e kultivimit të kanabisit

Nga ana e Institucioneve të përfshira në planin e veprimit janë hartuar planet e tyre të veprimit, për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në planin e veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020

Krahasuar me vitin e kaluar, si rezultat i sensibilizimit, ndërgjegjësimit, bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimtarisë në mes të të gjitha institucioneve të përfshira në Task Forcën Vendore dhe me Njësitë e vetëqeverisjes Vendore, për realizimin e detyrave të përcaktuara në planet operacionale të tyre, në zbatim të planit kombëtar kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020, është zvogëluar sip. dhe numri i bimëve të kanabisit të kultivuara mbi 26 herë (nga 417391 rrënjë/fidan/kubik/bimë të kultivuara dhe të asgjësuara në 15875 rrënjë/fidan/kubik/bimë, ose 401516 më pak këtë vit). Po kështu është rritur shkalla e zbulueshmërisë me 46 % (nga 12 % në 58 %) dhe forca goditëse (gjatë vitit 2017 janë ndjekur penalisht 96 autorë, nga 76 autorë të ndjekur gjatë vitit të kaluar, ose 20 autor më shumë).

V.4.2. Zbatimi i masave për çështjet e luftës kundër trafikimit të personave

Është hartuar e miratuar plani i veprimit të luftës kundër trafikimit të personave për vitin 2017, për qarkun Shkodër (plan i cili u është dërguar anëtarëve të Komitetit Rajonal)

Janë zhvilluar Mbledhjet e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave (I krijuar me Urdhër Nr. 6, datë 26.01.2017, të Kryeministrit “Për Krijimin e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave, në çdo Qark”), ku është miratuar edhe Rregullorja e funksionimit të këtij Komitetit (në përputhje me rregulloren tip.), si dhe problemet e veprimtarisë së luftës kundër trafikimit të personave, përfshirë edhe çështjet dhe rekomandimet e tryezës teknike.

Janë zhvilluar takimet periodike të tryezës teknike (të ngritur me Urdhër Nr. 11, datë 24.03.2017, të Prefektit/Kryetarit të Komitetit Rajonal), me përfaqësuesit e institucioneve/anëtarëve të komitetit rajonal dhe shoqërisë civile, në të cilat është rekomanduar që të kërkohet nga anëtarët e Komitetit:

- Rritja e nivelit të bashkëpunimit të gjitha institucioneve në luftën kundër antrafikimit të personave, në mënyrë të veçantë informimi nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale, lidhur me nxënësit që nuk vazhdojnë arsimin, kanë ndërprerë shkollën, nuk frekuentojnë rregullisht shkollën;
- Organizimi i trajnimit të punonjësve mësimor, veçanërisht i psikologëve të shkollave, lidhur me çështjet e luftës kundër trafikimit të personave;
- Mundësimi i ndërtimit të 1 qendre rezidenciale për qarkun, brenda territorit të bashkisë Shkodër, në të cilën është përqendruar rreth 61 % e popullsisë së qarkut (Me fondet e buxhetit të shteti, të njëjste të vetëqeverisjes vendore, me fondet nga donator, etj) për pritjen dhe akomodimin e personave Viktima/Viktima të Mundshme të Trafikimit dhe probleme të tjera të veprimtarisë antitrafikim

Është organizuar takimi i Komitetit Rajonal dhe Tryezës Teknike, lidhur me aktivitetet që do të zhvillohen gjatë muajit Tetor (*i nominuar si muaji i luftës kundër trafikimit të personave*), takime në të cilat është miratuar kalendari i veprimtarive (me të drejtë ndryshimi mbi bazën e propozimeve nga aktor, apo partner të ndryshëm, të cilët kanë vullnetin me dhënë kontributin e tyre në këtë sipërmarrje të përbashkët antitrafikim) dhe sllogani *#Bashkë Mundemi!#Luftojmë Trafikimin!*, Janë zhvilluar aktivitet e programuara gjatë muajit Tetor, sipas kalendarit, duke bërë edhe publikimin e tyre (*Vlen të theksohet se në ekspozitën kombëtare të punimeve të nxënësve të shkollave të sistemit parauniversitar, nga 9 çmime fituese, 6 prej tyre i përkasin qarkut Shkodër, përfshi edhe vendin e parë*).

Po kështu është zhvilluar takimi me anëtarët e Komitetit Rajonal dhe të Tryezës Teknike (në muajin Dhjetor), për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e shtetasve, lidhur me parandalimin e migracionit të parregullt drejt shteteve të BE me slloganin *“Zgjidhni mundësite, Jo migracionin e parregullt”*

Gjate vitit, nga intervistimi, deklarimi dhe vlerësimi i situatës për 283 raste (18 raste të intervistuar nga Drejtoria e Policisë Vendore, 265 raste të kapur dhe deportiv e të kthyer në kufi, të intervistuar e vlerësuar nga Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit, të vlerësuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, fëmijëve të pashoqëruar nga prindërit, etj.) kanë rezultuar VT 2 shtetas të mitur (1 shtetase, në një nga 4 bazat e prostitucionit të zbuluara, e cila, me dëshirën e saj, është sistemuar në qendër rehabilituese, për viktimat e trafikimit. Po kështu 1 shtetas i mitur, i akomoduar në qendrën rehabilituese për VT); Ndërsa si VMT nuk është identifikuar asnjë rast.

Për veprime të mëtejshme në 1 rast procedura i është referuar Krimeve të Rënda, ndërsa 2 raste Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës Parë Shkodër.

Nga shërbimet e policisë kufitare dhe të migracionit janë kapur 205 persona në kufi, nga vendet në konflikt, nga të cilët 178 shtetas janë dërguar në Qendrën e Azil Kërkuesve (134 kanë kërkuar azil në vendin tonë)

Nga trajtimi me ndihmë ekonomike i 8552 familjeve në qark, kanë përfituar 141 fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian, 842 familje me k/familjar gra dhe gra të divorcuara, si dhe 26 jetim.

Gjatë këtij viti arsimor (2017-2018) nuk janë regjistruar në shkollë 35 fëmijë, për të cilët, në bashkëpunim me institucionet vendore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, po merren masat e duhura për regjistrimin e tyre. Në shkollat të arsimit parauniversitar është

braktisur mësimi nga 137 nxënës (141 nxënës gjatë periudhës Janar-Qershor, që i përket vitit arsimor 2016-2017 dhe 115 nxënës gjatë këtij vitit arsimor), nga te cilët, gjatë këtij viti arsimor (2017-2018) 46 i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, 47 femra.

Është ofruar shërbim nga bashkia Shkodër, për fuqizimin e familjes dhe përmirësimin e kushteve social-ekonomike për 2 VMT (të identifikuar gjatë tre mujorit IV-të të vitit 2016)

Janë identifikuar dhe evidentuar 66 raste të fëmijëve të rrugës (Nga bashkia Shkodër 65 dhe nga bashkia Vau i Dejës 1), për të cilat janë:

- Hartuar planet e ndërhyrjes për integrimin;
- Mbështetur me ndihma ushqimore, veshmbathje e ilaçeve për fëmijët, të cilët kanë patur probleme shëndetësore;
- Mbështetur nga ana psiko-sociale, lehtësim dhe orientim për procedurat administrative, punësim, ndihmë ekonomike, etj.

Po kështu gjatë vitit janë identifikuar 8 fëmijë të pargjistruar, për të cilët vazhdon puna për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar për regjistrimin e tyre

Numri i punëkërkuarve të papunë ka qenë gjithsej 7055 (femra 3459), nga të cilët të komunitetit rom dhe egjiptian 299, jetim 10, emigrant të kthyer 45 dhe persona të trafikuar nga punëkërkuarët e papunë nuk ka

Trafikimi i personave, ka patur rënie të treguesve të evidentimit, e cila ka ardhur si rezultat i rritjes së nivelit të bashkëpunimit të Komitetit Rajonal Antitrafik, strukturave të policisë së shtetit, njësisë të vetëqeverisjes vendore, institucioneve qendrore në nivel vendor, shoqatave dhe individëve të ndryshëm, si dhe koordinimit të veprimtarisë nga Institucioni i Prefektit.

V.6. Masat e marra për përballimin e situatave nga emergjencat

Mbi bazën e planit vjetor të miratuar, në të cilin janë parashikuar dhe planifikuar të gjitha detyrat e sektorit, të shtrira sipas muajve por edhe sipas specifikave të emergjencave të pritshme që e karakterizojnë territorin e Qarkut Shkodër bazuar edhe në përvojën e krijuar në vitet e shkuara, është organizuar dhe kryer veprimtaria gjatë vitit, e cila konsiston:

- Janë organizuar 6 mbledhje të KECQ (Janar, Qershor, Korrik, Gusht, Nëntor, Dhjetor), ku janë deleguar detyra për përballimin e emergjencave sezonale dhe marrjen e masave planifikuese dhe organizative për emergjencat e pritshme.

- Është miratuar Rregullorja e funksionimit të brendshëm e KECQ të cilën e ka tashmë çdo anëtar dhe normon punë e KECQ në situatë normale dhe në situatë emergjente

- Janë hartuar dhe abdetuar; Plani i Perballimit të Emergjencave në nivel Qarku; Plani Evakuimit; Plani i Gadishmerisë me skenar për zolimën nga debora dhe permbytjet; Plani i bashkëpunimit të strukturave monitoruese, vepruese dhe operacionale; Si dhe janë përditësuar pikat e kontaktit, mënyrat e marrjes së informacionit dhe shkëmbimin e ndersjelltë më të gjitha institucionet qendrore dhe lokale.

- Janë përcaktuar dhe evidentuar burimet dhe kapacitetet njerzore dhe logjistike që disponon Qarkut dhe çdo drejtori në nivel qendror dhe lokal si dhe janë përcaktuar parashikimet e dëmeve të mundshme në dy skenarët (Izolimi nga debora dhe Përmytjet) si

dhe janë përcaktuar kërkesat për mbështetje logjistike nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile.

- I është kushtuar vëmendje ndjekjes konkretisht në terren të dinamikës së krijuar për shkak të emergjencave si dhe kordinimit dhe mbështetjes së strukturave, anëtare të KECQ, për normalizimin e situatave të krijuara nga rreshjet e shiut, dhe të dëborës, si dhe të emergjencave verore. Është bashkëpunuar dhe inspektuar në bashkëpunim me Autoritetin Verior të Rrugëve për ndjekjen dhe mbikqyrjen e veprimtarisë së kësaj strukture në hapjen e akseve nacionale në të gjithë territorin e Qarkut. Për këtë janë bërë inspektime konkrete, takime edhe ballafaqime për cilësinë e këtyre strukturave për hedhjen e kripës granilit në akset problematike për shkak të ngricave dhe temperaturave të ulëta. Është konstatuar se situata emergjencave dimërore në vitin 2017 është menaxhuar, monitoruar me kujdes, duke e konsideruar atë të suksesshme si pasojë e kordinimit të këtyre strukturave dhe mbikqyrjes maksimale të ndjekura sistematikisht nga Institucioni i Prefektit. Vazhdon të ngelet problem tradicional i mbartur ndër vite bllokimi i segmenteve të Qafë Thores dhe atij që lidh NJA të Postribës, Pultit, Shoshit, Shalës, Thethit. Përpjekjet e Institucionit të Prefektit kanë qënë të vazhdueshme dhe këmbëngulës por specifika e këtij terreni e bën të domosdoshëm tashmë një ndërhyrjen e domosdoshme definitive me një projekt të mirëstudiuar i cili duhet të bëhet për ndërtimin e të gjithë këtij segmenti që nga pjesa e ngelur e pa përfunduar në Qafë Thore dhe vazhdimin e saj deri në Prekal duke lidhur NJA e mësipërme

- Në zbatim të rekomandimeve të auditimit të ushtruar në Institucionin e Prefektit, është kërkuar informacion:

- Institucioneve dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore, mbi financimet e kryera sipas burimit të financimit, për situatat emergjente apo rabilitimin e objekteve sociale në qarkun Shkodër (financimi nga Ministria e Bujqësisë apo institucione të tjera). Po kështu vlerësimin e riskut dhe prioritetin e nevojat më emergjente, për ndërhyrje në objekte sociale.

- Qendrës së Rekrutim Mobilizimit, për shtetasit të cilët gjatë shërbimit ushtarak janë specializuar në shërbime të mbrojtjes civile.

- Drejtorisë Arsimore Rajonale, për shtetasit, të cilët kanë përfunduar arsimin e lartë dhe janë specialist të fushave përkatëse.

- DPGjC të dhënat e plota për shtetasit në territorin e qarkut, me moshë nga 18 deri në 55 vjeç për gratë dhe deri në 60 vjeç për burrat

- Koordinimi dhe ndërhyrja në kohë e Institucionit të Prefektit me institucionet anëtare të KECQ, bëri të mundur edhe shmangien e një përmytjeje të mundshme në zonën e nënshkodërs në fund muajin Nëntor dhe fillim muajin Dhjetor

Inspektimi i elementeve parandaluese dhe mbrojtëse si dhe ndërhyrja në pikat më problematike ka qënë një nga prioritetet, i organizuar në mënyrë periodike, sidomos në argjinatura (Lumit Kir, lumit Buna, në zonën e Darragjatit). Gjithashtu është inspektuar dhe është kërkuar ndërhyrje për në përroin në Anën e Malit

Në muajin Qershor është organizuar mbledhja e KECQ për menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota, është hartuar plani i masave dhe është dërguar urdhëri i Prefektit për të gjitha strukturat ligjzbatuese për menaxhimin e zjarreve të pritshme, ku vëmendje e veçantë i është kushtuar garantimit të parqeve kombëtare dhe plazheve si dhe garantimit të turizmit malor për parandalimin e zjarreve dhe garantimin e sezonit turistik.

Situata e zjarreve masive që ndodhën në periudhën Qershor 2017 deri më Shtator 2017 në disa raste krijuan probleme të mprehta duke rrezikuar seriozisht jetën e njerëzve, pronën private dhe publike. Më problematike kanë qenë vatrat e zjarrit në zonat urbane, kryesisht në afërsi të banesave dhe objekteve social kulturore, por në veçanti në zonat rurale të fshatrave. Konkretisht mund të përmendim vatrat e zjarrit në Bashkinë Shkodër (NJA Bardhaj, Postribë, Guri i Zi, Reç në Velipojë, Bërdice, Bushat, Gajtan, Shirokë.). Në bashkinë Vau Dejës (NJA Bushat, Temal, Cukal.). Në Bashkinë M.Madhe (Pylli i Gështenjave, Reç, Kastrat, Gruemirë, Qendër Koplik. Kurora e Gjëlber, në Bashkitë Pukë dhe Fushe-Arrëz ku u rrezikuan seriozisht shtëpите dhe biznese), etj. Është organizuar shërbimi i gadishmerisë mbi bazën e një grafiku pranë Institucionit. Është bashkëpunuar me të gjitha strukturat vartëse të Ministrisë së Mjedisit, si me ISHM, strukturat e bashkive, Repartin 1010 Vau Dejës. Është bashkëpunuar dhe është siguruar mbështetja e Drejtorisë së Përgjithshme e Emergjencave Civile sidomos për territore tepër të vështira për fikjen e zjarreve nëpërmjet ajrit. Gjatë monitorimit dhe ndjekies së dinamikës si dhe organizimit të operacioneve të ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve, theksojmë se në të shumten e rasteve ato janë drejtuar nga Sektori i Perballimit të Emergjencave dhe Krizave në të gjithë pothuajse në të gjithë territorin e Qarkut, vetem gjatë periudhës Korrik-Gusht me kërkesën e Prefektit bazuar në kërkesat e kryetarëve të bashkive dhe mbështetur nga DPEC janë organizuar 23 operacione nga ajri me helikopter, 20 operacione me ushtarë dhe 6 operacione të ndërthurura me ushtarë dhe të mbështetura nga ajri. Ndërhyrja me helikopter ka qenë efikase, pasi ka parandaluar djegien e fondeve pyjore, ullishteve, blegtorisë, objektet privatë dhe shtetërore pothuajse në të gjitha vatrat e zjarrit të shfaqura në territoret e pesë bashkive të Qarkut Shkodër.

Për shuarjen e 682 vatra zjarri në teritorin e Qarkut Shkodër, vatra të cilat kanë përshkuar një sipërfaqe prej 1603 Ha, duke djegur 804.7 Ha (Dëmi ekonomik nga zjarret llogaritet në vlerën 1,588,820 mijë lekë), kanë marrë pjesë në operacione Institucioni i Prefektit (6 punonjës me një mjet); Bashkitë më administratat e tyre, PMNZSH-te, strukturat e emergjencave civile vendore (në nivel qarkut me 89 forca me 7 mjete, nga të cilat; Bashkia Shkoder 3 mjete dhe 35 forca, Bashkia Pukë 2 mjete dhe 14 forca, Bashkia M.Madhe 2 mjete dhe 17 forca, Bashkia Fushe Arrëz me 9 forca, si dhe Bashkia Vau Dejes me 14 forca pa mjete); Drejtoria Vendore e Policisë (130 forca me 30 mjete); Reparti i FNSH (100 forca me 2 mjete); Forcat e Armatosura të Rep.Usht.Nr.1100 në Vau Dejës (200 forca me 10 mjete); Administratoret dhe komuniteti i të gjitha bashkive; Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve; Administrata e Zonave të Mbrojtura.

Nga bashkitë dhe Drejtoria e Ujrave dhe Kullimit Lezhë, bordet e kullimit pranë çdo bashkie, është kërkuar funksionimin dhe vënien në gadishmeri të gjithë sistemit ujësjellës-kanalizimeve dhe masat shtesë që duhet të marrin ndërmarrjet përkatëse vartëse. Vënien në gadishmeri teknike të stacioneve të pompimit të hidrovorëve dhe rrjetin e furnizimit me energji elektrike e tyre, të mbikqyrin dhe vlersojnë të gjithë sistemin e argjaturave në ultësirën e Shkodrës, mirëmbajtja e çdo sistemi kullimi, për të parandaluar përmytjet. Përditësimin e të gjitha të dhënave për resurset që disponojnë Bashkitë, institucionet, bazën materiale dhe teknike nën administrimin shtetëror dhe privat, si dhe përcaktimin e mënyrës së përdorimit të tyre në rast situatë emergjente. Evidentimi dhe kontrolli i të gjitha digave dhe bambave në juridiksionin territorial të tyre. Nga HEC Vau Dejës, Koman dhe Fierzë është

kërkuar që të ngrihet dhe të funksionojë shtabet për marrjen e masave të duhura për mirëmbajtjen, vrojtimin dhe sigurinë e digave dhe veprave shkarkuese, nëpërmjet grupeve të punës me specialistët përkatës.

Bashkëpunimi me strukturat e policisë shtetit (DVP dhe strukturat e saj), ka qenë i sukseshëm gjatë situatave emergjente të krijuara. Strukturat e policisë kanë qënë shumë efektivë në transmetimin e informacioneve dhe kanë treguar gadishmëri maksimale në stabilizimin e qarkullimit rrugor në rastin e ngricave dhe në ndihmë ndaj komunitetit në nevojë në të gjitha situatat emergjente.

Edhe me strukturat e Shtabit të Përgjithshëm, ato të Rep. 1010, të dislokuar në bashkinë Vau Dejës kemi bashkëpunuar intensivisht, në bazë të planeve Operacionale sidomos në parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota që gjatë vitit 2017 kanë qënë të shpeshta dhe të shtrira në zona të ndryshme të Qarkut.

Propozime dhe probleme që kërkojnë mbështetje për ndërhyrje.

Mbi bazën e një plani kontrolli vjetor në bashkëpunim edhe me Sektorët e tjerë të Institucionit here pas here kemi bërë inspektime konkrete në terren apo kemi kërkuar informacion për masat parandaluese në të gjitha zonat e rrishtit të bashkive duke evidentuar problematikat dhe duke evidentuar ndërhyrjet përkatëse në këto zona, për këto kemi kërkuar përgatitjen e projekteve përkatëse nga bashkitë të cilat i kemi dërguar për miratim dhe zbatim pranë DPEC. Disa nga problematikat e konstatuara gjatë vitit 2017, për ndërhyrjen në sistemin mbrojtës dhe parandalues kërkohet

Në Bashkinë Vau Dejës. Është kërkuar projekti **për** ndërhyrje urgjente në perroi Gline në lagjen Kapedan të Bashkisë Vau Dejës (qender) pasi prurjet kanë gërryer njëren anë të tij dhe rrezikohen seriozisht disa banesa.

Në Nj.A Rrethina vazhdon të jenë shqetësuese prurjet e Lumit Kir, i cili ka dëmar në 3(tre) vende argjinaturat kryesore (fshatrat Bleran, Golem, Kuq) për të cilat është kërkuar projekti që të ndërhyhet në mënyrë emergjente.

Në Nj.A Ana e Malit, fshati Oblikë, vazhdon të gërryhet toka bujqësore si pasojë e prurjeve të Lumit Buna, një sipërfaqe e cila është 27 ha tokë bujqësore. Nuk është përfunduar projekti për mbrojtjen e kësaj zone miratuar nga Ministria e linjës sipas të cilit është parashikuar veshja e bregut me gur, gjë që ka bërë që të zgjerohet aktiviteti gërryës duke dëmtuar sipërfaqe të konsideruara tokë bujqësore. Kërkohet ndërhyrje Juaj për përfundimin e këtij projekti.

Në Nj.A Guri i Zi, në fshatin Kuq është e njëjta situatë ku vazhdon të gërryhet toka bujqësore si pasojë e prurjeve të Lumit Kir nga devijimi që i është bërë nga punimet pa kriter të firmave private të zhavorishteve në këtë zonë. Për këtë nga Institucioni i Prefektit është kërkuar nga DPEC të ndërhyhet me fondet emergjente dhe është bërë ndërhyrja nga firmat private gjatë janarit të vitit 2016

Në Nj.A Postribë, në fshatin Myselim të kësaj komune, pranë kanalit të Shtodrit si pasojë e prurjes së inerteve është bllokuar përroi që derdhet në këtë kanal dhe për pasojë në situatë reshje prurjet e këtij përroi anashkalojnë kanalën dhe derdhet në fshatrat Mes dhe Myselim duke përmbytur rreth 6 Ha tokë dhe rreth 10 shtëpi të fshatit Myselim. Është

bashkëpunuar me Bordin e Kullimit për të bërë ndërhyrjen e duhur për pastrimin e këtij kanali.

Në Nj.A Hajmel, kërkohet ndërhyrje për pastrimin e Kanlit të Gjadrit dhe përroit të Glinës deri në derdhjen fundore të tyre, pasi tradicionalisht krijohenn probleme përmytje dhe bën kullimin e tokave për parandalimin e përmytjeve në fshatrat Pacram dhe Pistull.

Në Nj.A Dajç, është amortizuar së tepërmi nga erozioni dhe gërryerjet argjinatura pranë fshatit Darragjat, për të cilën kërkohet ndërhyrje emergjente, pasi pasojat në rastet e reshjeve do të jenë shumë të dëmshme për shtepitë e banorëve përreth.

Në Nj.A. Velipojë, problem shqetësues është përmytja e fushës së Çasit (ish kënet), sipërfaqe kjo e mbjellë me kultura bujqësore. Shkak i kësaj situate është mospastrimi i kanalit kryesorë (Mgjistrali) KK-1 me gjatësi 4200 ml, mbi magjstral janë ndërtuar dy ura për të kaluar në parcelat bujqësore të cilat kanë seksion të vogël dhe krijojnë bllokimin e shkarkimit ujrave dhe për pasojë shkaktojnë përmytje. Janë bërë ndërhyrjet e duhura për pastrimin e këtij kanali.

Propozime dhe probleme që kërkojnë mbështetje për ndërhyrje.

- Domosdoshmeria e miratimit të Ligjit të ri Për Emergjencat Civile është imediat për mirëfunksionimin e strukturave në varësi të bashkive dhe ato në nivel qendror me qëllim menaxhimin më eficient të situatave të pritshme në të gjithë territorin e Qarkut (Duke rregulluar dhe masën e fondit rezervë-emergjence, në masën 3 %)

- Përcaktimi i kriterëve të drejtorive të emergjencave, sektoreve të emergjencave pranë cdo bashkie dhe përcaktimi i mardhenieve të tyre me sektoret e emergjencave në Prefekturë është një domosdoshmeri për delegimin dhe ndjekjen më përgjegjeshmeri të situatave të pritshme dhe mbi të gjitha shfrytëzimit të resursëve njerëzor dhe logjistik pranë cdo bashkie, duke minimizuar kërkesat pa kriter që bëhen për cdo emergjence pranë Institucionit të Prefektit dhe duke lënë pa shfrytëzuar resursët njerëzor dhe logjistikë që ushtrojnë aktivitetin pranë cdo bashkier.

- Hartimi i Planeve të Përballimit, planeve të lajmerimit të hershme nga cdo bashki është detyrë imediate ligjore dhe duhet të parashikohen sanksione ligjore për personat përgjegjës të strukturave emergjente pranë cdo bashkie në rastet e moshartimit të tyre në kohën e parashikuara me Ligj.

- Depozitimi i mbetjeve urbane të cilat janë të shtrira në të gjithë territorin aktual të bashkive, janë një problem tepër shqetësues që inkurajojnë përmytjet në situatat e reshjeve. Për këtë duhet të merren masat konkrete nga bashkitë për të bërë evidentimin dhe përgatitjen e projekteve konkrete për disiplinimin e tyre.

- Fondi rezerve deri në 3%, është një fond i pa përfillshëm për territorin aktual, dhe për këtë kërkohet një rritje deri në 5 % me qëllim që të përgjigjet menaxhimit të situatave emergjente.

- **VKM. Nr. 965 dt.02.12.2015 “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave”**...ne lidhje me zbatimin e këtij VKM, është ngritur pranë Institucionit të Prefektit Sektori por nuk është plotësuar organika me dy specialist pasi kemi vetëm një specialsitë në organikë, akoma nuk është plotësuar me specialsitin e dyte, ndërsa në bashkinë Shkodër është ngritur si Drejtori,

por ne këtë strukturë janë aktualisht dy specialist, akoma nuk është emeluar Drejtori dhe dy specialistët e tjerë pranë kësaj drejtorie. Ne bashkitë e tjera janë ngritur sektoret dhe janë kompletuar me specialistët përkatës.

- **Problem shqetësues për plotësimin e drejtorive dhe sektorëve mbi bazën e VKM është sepse nuk plotësohen kriteret e rekrutimit të specialistëve pranë drejtorive apo sektorëve që ndikon në mbarëvajtjen apo eficienten në punë të këtyre strukturave në menaxhimin e situatave. Strukturat e funksionimit të DAP lënë shume për të dëshiruar në këtë drejtim.**

VI. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT ME NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

Marrëdhënit e Prefektit të qarkut me njësitë e vetëqeverisjes vendore (Këshillin e qarkut dhe bashkitë), të përcaktuara edhe në Ligjin “Për Prefektin e qarkut” dhe “Për vetëqeverisjen vendore”, kanë qenë marrëdhënie konsultimi dhe bashkëpunimi për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë asistuar me ndihmën e nevojshme juridike në mënyrë qoftë verbalisht, apo edhe me dhënie Udhëzimesh, Rekomandimesh, deri edhe në takime lidhur me problemet që kanë organet drejtuese në interpretimin dhe zbatimin akteve ligjore e nenligjore.

Është bashkëpunuar për ushtrimin e funksioneve të transferuara nga Ministrinë dhe Institucionet qendrore tek njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke mbikqyrur e monitoruar përdorimin e fondeve të transferuara nga buxheti (në formën e transfertës specifike) për kryerjen e këtyre funksioneve

VI.1. Kyerja e funksioneve të transferuara njësite të vetëqeverisjes vendore

Në përmbushje të misionit dhe përgjegjësisë, mbështetur në Ligjin “Për Prefektin”, Vendimet e KM dhe Udhëzimeve në zbatim të tyre, është bashkërenduar puna me njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë) për ushtrimin nga ana e tyre, të funksioneve të transferuara nga institucionet qendrore, duke mbikqyrur dhe monitoruar fondet e transferuara (transferten specifike) për kryerjen e këtyre funksioneve, për:

1.1. Shërbimin e Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin

Gjatë vitit fondet nga transfertat specifike, për kryerjen e shërbimit janë rritur me 23,069 mijë lekë, ose 45.9 % krahasuar me vitin e kaluar

Janë kryer shpenzime me vlerë 68,517 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 9,711 mijë lekë; Shkoder 32,414 mijë lekë; Vau i Dejës 7,917 mijë lekë; Pukë 13,274 mijë lekë dhe Fushë Arëz 5,201 mijë lekë), ose 81.3 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 16,082 mijë lekë, i cili është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2018.

1.2. Rrjetin e rrugëve rurale

Gjatë vitit fondet nga transferta specifike, për Mirëmbajtjen e rrugëve rurale, janë rritur me 1,095 mijë lekë, ose 2 % krahasuar me vitin e kaluar

Janë kryer shpenzime me fondet nga transferta specifike me vlerë 69,905 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 10,942 mijë lekë; Shkoder 14,052 mijë lekë; Vau i Dejës 9,133 mijë lekë; Pukë 18,225 mijë lekë dhe Fushë Arëz 10,553 mijë lekë), ose 51 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 60,317 mijë lekë, i cili është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2018

1.3.Pyjet dhe kullotat publike

Gjatë vitit fondet nga transferta specifike, për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave, janë rritur me 7,596 mijë lekë, ose 45.9 % krahasuar me vitin e kaluar

Janë kryer shpenzime me vlerë 29,109 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 7,154 mijë lekë; Shkoder 6,835 mijë lekë; Vau i Dejës 2,924 mijë lekë; Pukë 6,321 mijë lekë dhe Fushë Arëz 5,875 mijë lekë), sipas shpenzimeve të programuara

1.4. Sistemin e ujitjes dhe kullimit

Gjatë vitit fondet nga transferta specifike, për kryerjen e shërbimit në sistemin e ujitjes dhe kullimit, janë rritur me 26,436 mijë lekë, ose mbi dy herë, krahasuar me vitin e kaluar

Janë kryer shpenzime me vlerë 53,320 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 9,177 mijë lekë; Shkoder 16,639 mijë lekë; Vau i Dejës 10,635 mijë lekë; Pukë 25,333 mijë lekë dhe Fushë Arëz 713 mijë lekë), ose 67.7 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 25,424 mijë lekë, i cili është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2018

1.5.Arsimi parashkollor, arsimi parauniversitar, konviktet e arsimit parauniversitar

Gjatë vitit fondet nga transferta specifike, për sistemin e arsimit (bazë, mesem dhe konviktet e arsimit parauniversitar), janë rritur me 21,323 mijë lekë, ose 5.1 % krahasuar me vitin e kaluar

Janë kryer shpenzime me vlerë 405,439 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 50,152 mijë lekë; Shkoder 225,346 mijë lekë; Vau i Dejës 41,016 mijë lekë; Pukë 56,985 mijë lekë dhe Fushë Arëz 31,940 mijë lekë), ose 92.3 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 33,595 mijë lekë, i cili është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2018

1.6.Perkujdesi social

Gjatë vitit fondet nga transferta specifike, janë programuar fonde afërsisht në njëjtën vlerë me vitin e kaluar

Janë kryer shpenzime me vlerë 19,770 mijë lekë (bashkia Shkoder), ose 95.4 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 956 mijë lekë

Pasqyra, lidhur me planifikimin dhe përdorimin e fondeve për ushtrimin e funksioneve të transferuara (transfera specifike), përmbledhëse dhe sipas bashkive

Përmbledhëse

Në mijë lekë

Nr.	Bashkia	Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për Buxh. Famil. e individ		Investime		Shuma	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	M.Madhe	62,488	57,264	10,373	9,571	13,841	8,454	204	193	1,160	960	88,066	76,417
2	Shkoder	213,382	206,287	37,174	35,411	92,232	52,926	18,783	17,901	3,100		365,240	313,030
3	Vau Dejës	54,175	50,513	9,076	8,428	8,684	0	0	0	5,000	5,000	76,935	71,412
4	Pukë	64,399	62,936	11,274	10,448	16,999	10,078			74,555	35,977	167,227	119,439
5	Fushë Arëz	51,229	44,589	8,813	7,630	11,282	1,628			4,000		75,324	53,847
	Qarku	445,673	421,589	76,710	71,488	143,038	73,086	18,987	18,094	87,815	41,937	772,792	634,145

1. Bashkia Malësi e Madhe

Në mijë lekë

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për Buxh.famil. e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infrastr. Ujitjes dhe Kullimit	01	04240	3,211	2,870	536	479	7,471	5,828					11,218	9,177
Administrimi i pyjeve	01	04260	4,690	4,690	780	780	1,657	649	28	28			7,154	6,146
Mbrojtja e pr.buj.e blegt	01	04520	9,400	8,008	1,494	1,337	3,771	1,597			200		14,865	10,942
Arsimi bazë (përfshi parash.)	01	09120	38,775	35,403	6,498	5,916			136	125			45,409	41,443
Arsimi i mesëm (përfshi konvikt.)	01	09230	6,412	6,293	1,066	1,060	942	380	40	40	960	960	9,420	8,709
Shërbimi i MZSh-së	01	10910	10,372	7,715	1,752	1,300	1,424	697					13,548	9,711
Totali			62,488	57,264	10,373	9,571	13,841	8,454	204	193	1,160	960	88,066	76,417

2. Bashkia Shkodër

Në mijë lekë

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për Buxh.famil. e individ e të brend.		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Menaxhim Infastr. Ujitjes dhe Kullimit	01	04240	11,340	7,026	1,496	1,217	18,297	8,346	50	50			31,184	16,639
Administrimi i pyjeve	01	04260	5,061	3,360	829	607	945	932					6,835	4,899
Rrugë rurale	01	04520					25,368	14,052			3,100		28,468	14,052
Arsimi bazë (parashkollor)	01	09120	133,614	133,022	23,602	22,357			356	313			157,572	155,692
Arsimi i mesëm (përgjith.)	01	09230	36,540	36,540	6,764	6,764	43,216	26,158	102	102			86,622	69,654
Përkujdesi social	01	10430	1,048	1,048	94	94	801	727	18,783	17,901			20,726	19,770
Shërbimi i MZSh-së	01	10910	25,779	25,291	4,389	4,372	3,605	2,711	60	40			33,833	32,414
Totali			213,382	206,287	37,174	35,411	92,232	52,926	18,783	17,901	3,100		365,240	313,030

3. Bashkia Vau i Dejës

Në mijë lekë

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për Buxh.famil. e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infastr. Ujitjes dhe Kullimit	01	04240	2,711	2,711	453	453	7,471	7,471					10,635	10,635
Administrimi i pyjeve	01	04260	2,323	2,323	388	388	213						2,924	2,711
Rrugë rurale	01	04520	4,755	3,542	794	591					5,000	5,000	10,549	9,133
Arsimi bazë (parashkollor)	01	09120	27,200	27,200	4,542	4,542							31,742	31,742
Arsimi i mesëm (përgjith.)	01	09230	8,926	7,953	1,499	1,321							10,425	9,274
Arsimi (konviktet)	01	09240												
Shërbimi i MZSh-së	01	10910	8,260	6,784	1,400	1,133	1,000						10,660	7,917
Totali			54,175	50,513	9,076	8,428	8,684	0	0	0	5,000	5,000	76,935	71,412

4. Bashkia Pukë

Në mijë lekë

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për Buxh.famil. e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infastr. Ujitjes dhe Kullimit	01	04240	765	701	144	117	2,481	1,354			30,994	23,162	34,384	25,333
Administrimi i pyjeve	01	04260	4,682	4,472	936	745	703	405					6,321	5,622
Rrugët rurale	01	04520	4,089	3,530	651	542	2,463	1,849			42,514	12,304	49,717	18,225
Arsimi bazë (përfshi parash.)	01	09120	32,070	31,519	5,539	5,300	1,774	1,130			500	326	39,883	38,275
Arsimi i mesëm (përgjith.)	01	09230	5,707	5,707	1,053	923	576	576					7,336	7,206
Arsimi (konvikti Pukë)	01	09240	6,806	6,806	1,130	1,130	6,621	3,383			547	185	15,104	11,504
Shërbimi i MZSh-së	01	10910	10,280	10,201	1,821	1,691	2,381	1,382					14,482	13,274
Totali			64,399	62,936	11,274	10,448	16,999	10,078			74,555	35,977	167,227	119,439

5. Bashia Fushë Arëz

Në mijë lekë

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për Buxh.famil. e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infastr. Ujitjes dhe Kullimit	01	04240	565	467	114	78	1,862	168					2,541	713
Administrimi i pyjeve	01	04260	4,539	4,419	909	737	427	284					5,875	5,440
Rrugët rurale	01	04520	9,900	8,194	1,730	1,369	7,993	990					19,623	10,553
Arsimi bazë (përfshi parash.)	01	09120	26,257	23,306	4,451	4,027							30,718	27,333
Arsimi i mesëm	01	09230	4,188	3,992	615	615							4,803	4,607
Shërbimi i MZSh-së	01	10910	5,780	4,211	994	804	1,000	186			4,000		11,774	5,201
Totali			51,229	44,589	8,813	7,630	11,282	1,628			4,000		75,324	53,847

VI.2. Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore dhe asistencë juridike për vendimmarrjen e këtyre akteve.

Në mbështetje të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Prefekti i Qarkut gjatë vitit ka vazhduar konsultimin dhe bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta, duke kryer edhe verifikimin e ligjshmërisë së akteve të nxjerra prej tyre.

Ligjshmëria e akteve normative të miratuara nga organet e njësive të qeverisjes vendore

Pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, njësitë e vetëqeverisjes vendore (5 bashki dhe Këshilli i Qarkut), janë depozituar gjithsej **459 akte normative**; nga të cilat:

-Për 345 akte normative Prefekti ka vlerësuar se janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore,

-Për 114 akte është shprehur negativisht për shkak se kanë qenë jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, 30 prej të cilave janë rishqyrtuar nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

- Për 1 akt (bashkia Pukë) çështja është dërguar në Gjykatë

Reforma territoriale, përqëndrimi në 5 bashki ka sjellë rënie të numrit të akteve në krahasim me vitet e mëparshme, për shkak edhe të qëndrimit institucional të prefektit, oponencës së bërë, duke vlerësuar se ka qenë frytdhënës, pasi janë vendosur praktika unifikuese në nivel administrativ, të cilat kanë qenë praktika të mira për t’u marrë në konsideratë.

Vazhdon të asistohen me ndihmë juridike qoftë verbalisht apo edhe me dhënie Udhëzimesh, Rekomandimesh, deri edhe në takime lidhur me problemet që kanë organet e pushtetit vendor në interpretimin e ligjit dhe zbatimin e drejtë të tij edhe pse ky sektor ka detyrë kontroll ligjshmërie.

Vëmendje është përqendruar:

a. Buxheteve të njësive të vetëqeverisjes vendore, për rishpërndarjen e fondeve buxhetore, vendime në të cilat duhet të përcaktohet qartë dhe gjithmonë, qëllimi dhe arsyeja e transferimit të këtyre fondeve në respekt të parimeve të funksionimit të sistemit buxhetor, atij të transparencës, parashikueshmërisë, unitetit dhe universalitetit në menaxhimin e sistemit buxhetor, respektimit të destinacionit të transfertave specifike,

b. Përdorimit të fondit rezervë/kontigjencë & emergjencë, të cilat është përdorur vetëm për raste të paparashikuara në buxhet dhe në përputhje me parimin e përdorimit ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve publike (respektimit të kriterëve të ligjit “Për emergjencat civile” dhe VKM Nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” duke respektuar afatet e VKM dhe procedurën, dhe pikërisht ky vit ka pasur shumë vendime të tilla në të cilat është konstatuar se nga administrata e NJQV si bashkia Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë për një pjesë të madhe të tyre nuk zbatoheshin afatet dhe procedurat që parashikon Vendimi i Këshillit të Ministrave.

Po kështu;

procedurave të seancave të këshillimit që duhet të bëjë këshilli bashkiak për atë lloj vendim-marrjesh sipas ligjit nr.139/2015

- Procedurave të seancave të këshillimit që duhet të bëjë këshilli bashkiak për atë lloj vendim-marrjesh sipas ligjit nr.139/2015

- Miratimi i sistemit fiskal të bashkive paraqet rëndësi jo të vogel për shqyrtim

- Lidhur me VKM-së nr.253, dt 6.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave” dhe VKM nr.222, dt 6.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve” ka pasur një reduktim të theksuar të VKB me objekt të tillë, duke kërkuar respektimin e kriterëve ligjore

- Miratimi i PPV si bashkia Shkodër, Malësi e Madhe, kjo në bashkëpunim me inxhinierin e Sektorit të Zhvillimit Urban,

- Dhënie në përdorim të pasurisë së paluajtshme duke respektuar kriteret ligjore dhe procedurën sipas llojit të pasurisë, apo tjetërsimit të saj, procedurat e shpronësimit,

- Edhe gjatë këtij viti ka qenë problem riorganizimi i ujësjellësit Pukë (kthyer negativisht dhe jo rishqyrtuar më nga këshilli bashkiak) dhe Fushë Arrëz (asnjëherë nuk është miratuar ndonjë VKB) sipas VKM Nr.63 dt.27.01.2016 “Për organizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura”. Edhe VKB Shkodër, Vau Dejës dhe Malësi e Madhe herën e parë janë kthyer negativisht pasi riorganizimi nuk ishte bërë sipas ndarjes së re administrative, si dhe nuk merrnin masa për vlerësimin e kapitalit. Për gjithë këtë proces është informuar Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Agjencia Kombëtare të Ujesjellës Kanalizime, Enti Rregullator të Ujit duke i kërkuar edhe dhënie asistencë për NJQV.

- Ka vazhduar shqyrtimi i VKB për shpërndarjen e ndihmës ekonomike referuar ligjit Nr. 9355 date 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar, VKM nr.376 dt 11.6.2014 për disa ndryshime dhe shtesa ne VKM nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave të masës së ndihmës ekonomike” dhe Udhëzimit Nr. 338/3 dt 10.03.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, te procedurave dhe te masës se ndihmës ekonomike”. Lidhur me përdorimin e fondit të ndihmës ekonomike, gjatë 2017 janë kthyer të gjitha VKB në rastet kur këshillat e NJQV kanë trajtuar familjet në një mase me te madhe se maksimumi i përcaktuar me ligj apo kanë përfshirë në listën e përfituese familje që nuk ishin pjesë e projekt-vendimit të përgatitur nga administrator i ndihmës ekonomike siç ka qenë rasti i bashkisë Malësi e Madhe, sipas sinjalizimit nga DRSHS Shkodër. Në disa raste VKB kanë pasur ndryshime në fond, i cili ka qenë pjesë e shprehjeve të ligjshmërisë për zbatim nga NJQV.

- I është kushtuar vëmendje listave të familjeve përfituese që duhet të jenë vetëm gra në përputhje me kriteret e VKM nr.376 dt 11.6.2014 për disa ndryshime dhe shtesa ne VKM nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave të masës së ndihmës ekonomike”. Jane ndjekur me vëmendje hyrjet, daljet dhe riperfshirjet ne skemen e ndihmes ekonomike te familjeve ne nevojë, dhe ne rastet kur jane konstatuar parregullsi është njoftuar struktura përgjegjëse Shërbimi Social-Drejtoria Rajonale Shkoder, si struktura

përgjegjëse për kontrollin në vend të dosjeve, me qëllim që minimumi jetik ta përfitojnë vetëm familjeve që plotësojnë realisht kriteret ligjore.

Sipas të dhënave nga strukturat përgjegjëse pranë çdo bashkie, vërehet se shpenzohen fonde në nivel jo të vogël për ndihmën ekonomike dhe paaftësinë por praktikisht ky mbetet fond i vogël për familjet

Ndryshimet ligjore sjellin risi pasi ndihma ekonomike shpërndahet një herë në muaj me vendim të strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, ndërsa pagesa e personave me aftësi të kufizuar shpërndahet një herë në muaj me vendim të këshillit bashkiak.

- Pavarësisht se këto nuk janë akte me karakter normativ, Prefekti ka vlerësuar ti sqarojë KB për të qenë më të saktë në vendim-marrjen e titujve të nderit sipas procedurës së ligjit Nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

- Gjithashtu Prefekti ka qenë një hallkë lehtësuese për bashkitë në saktësimin e procedurës të trajtimit me bursë nxënësit e vitit të parë të cilët trajtohen me bursë nga vendbanimi nga vjen nxënësi, sipas VKM nr.873/2016 & VKM nr.903/2016, kjo me qëllim mbrojtjen e nxënësit

Nga verifikimi në vend i akteve të Këshillave të njëjësive të Vetëqeverisjes Vendore është konstatuar

- Në Këshillin e Qarkut procesverbali i mbledhjeve nuk është i hartuar në përputhje me kriteret e përcaktuara (i është sjellë në vëmendje se procesverbali i mbledhjeve duhet të jetë sipas nenit 18 të ligjit nr.9154/2003 “Për Arkivat”, i cili duhet të protokollohej si kërkesë e ligjit). Sipas rregullores së KQ Shkodër nr.50 dt 2.11.2015, neni 11, janë të miratuar 7 komisione-Komisioni i mandateve, i buxhetit e financës, shërbimeve dhe emergjencave civile, politikave dhe planifikimit urban, administrimit dhe mbrojtjen e tokës bujqësore, i bashkëpunimit dhe marrëdhënieve me jashtë, komisioni juridik- i vlerësimit të figurave dhe shqyrtimit të kërkesave për pensione të posaçme shtetërore, për të cilat duhet të lihen gjurmë, pavarësisht se sipas sekretarit të këshillit u deklarua se diskutoheshin projekt-vendimet. Iu la detyrë të bëjnë plotësime të rregullores së tyre si akt nënligjor lidhur me funksionimin e komisioneve të këshillit dhe kryesisë.

- Në KB Shkodër u konstatua se të gjitha vendimet ishin depozituar në sekretarinë e Institucionit të Prefektit Qarkut Shkodër për shqyrtim. Risi ishte se që nga muaji maj 2017 ky këshill bën regjistrimin audio të mbledhjeve të KB Shkodër, një proces i rëndësishëm.

- Në KB Malësi e Madhe i është lënë masë e menjëhershme miratimi i rregullores së këshillit bashkiak, me qëllim detajimin e çështjeve të cilat nuk trajtohen sipas ligjit organik, duke parashikuar edhe funksionimin qartazi të komisioneve të përhershme apo të përkohshme të këshillit bashkiak, duke lënë gjurmë, detyrë e lënë nga Prefekti edhe në vitin 2016.

- Në KB Pukë u konstatua se të gjitha vendimet ishin depozituar në sekretarinë e Institucionit të Prefektit Qarkut Shkodër për shqyrtim.

- Në KB Fushë Arrëz u konstatua se të gjitha vendimet me karakter normativ ishin depozituar në sekretarinë e Institucionit të Prefektit Qarkut Shkodër për shqyrtim.

- Në KB Vau Dejës u konstatua se të gjitha vendimet me karakter normativ ishin depozituar në sekretarinë e Institucionit të Prefektit Qarkut Shkodër për shqyrtim.

Ndërsa për aktet normative të miratuara nga ana e kryetarëve të bashkive u konstatua:

Nga administratat e bashkive të qarkut Shkodër, nuk kishte bërë një klasifikim të akteve normative sipas urdhërave, vendimeve që kishte miratuar kryetari i bashkisë, edhe pse strukturat e tyre janë të ndërtuar sipas parimit të hirearkisë duke filluar nga niveli drejtori e përgjithshme e më poshtë, me nivel këshilltarësh, apo edhe me disa nënkryetarë.

-Kryetari i bashkisë- organ ekzekutiv kishte nxjerrë disa akte dhe nga administrata (në përbërje të së cilës ekzistojnë struktura në nivel drejtori e përgjithshme-drejtori-sektor, këshilltarë....) nuk ishte përgatitur një regjistër i veçantë, në të cilin përcaktohej se cilat konsideroheshin të tilla.

Referuar ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për Pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, VKM nr.1353/2008, gjatë verifikimit në vend në bashkinë Pukë & Fushë Arrëz te aktet e kryetarit është vënë re që pëlqimin për dhënie në përdorim për llojin pyll e ka dhënë organi ekzekutiv sipas VKM, por këto akte i përkisnin fazës kur nuk kishte iniciuar akoma reforma administrativo-territoriale dhe kjo procedurë realizohej direkt mes Ministrisë së Mjedisit dhe drejtorive rajonale të Mjedisit si strukturë në varësi. Me miratimin e ligjit të ri të qeverisjes vendore dhe VKM Nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/ bashkive”, janë njoftuar dy bashkitë dhe Ministria e Mjedisit (me qëllim unifikim praktike) se është domosdoshmëri vendim-marrja e këshillit bashkiak, për shkak se *dhënia në përdorim apo tjetërsimi i pronave është vendim-marrje vetëm e këshillit bashkiak (neni 9/12/c & neni 54/gërma e, ligjit të ri nr.139/2015), element jo i njohur nga vetë struktura e re e pyjeve, e transferuar.*

-Aktet e kryetarit të bashkisë me objekt rishpërndarje fondesh brenda të njëjtit program buxhetor për të cilat referuar ligjit nr.9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, neni 44, citohet se nëpunësi autorizues ka pasur detyrim informimin e këshillit bashkiak për çdo rishpërndarje, gjë të cilën nuk e konstatuam nëse ishte lënë gjurmë edhe gjatë kontrollit të akteve të këshillit bashkiak Shkodër. (*Mosnjoftimi i këshillit bashkiak-organ kolegjal konsiderohet cënim i dispozitës ligjore & mungesë transparencë*).

Proceset gjyqësore

Prefekti i Qarkut Shkodër, si paditës në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016, dt 2.10.2016 “Për Prefektin”, ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9948/2008 “Për shqyrtim të të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, VKM nr.253, dt 6.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit kryerjes të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore”, i ndryshuar, VKM nr.222 datë 6.3.2012 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-NB në pronësi të përfituesve”, VKM nr.337/2015 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-NB në pronësi të përfituesve”, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Shkoder kunder

Keshillit bashkiak Pukë dhe kryetarit të bashkisë, me objekt *Deklarim i pavlefshmërisë i aktit administrativ nr.37 datë 03.07.2017 rishqyrtim i VKB nr.32 datë 25.5.2017*, meqënëse këshilli bashkiak nuk i mori në konsideratë kërkesat e Prefektit, por miratoi të njëjtin vendim sipas së njëjtës procedurë. Meqënëse Prefekti ka të drejtën e kthimit vetëm një herë të një akti, të qënurit në këto kushte, iu drejtua gjykatës kompetente për pavlefshmeri të aktit.

Gjithashtu ky vit ka pasur ankime, rekurs apo apelim, procese gjatë të cilave është marrë në konsideratë nga sistemi gjyqësor qëndrimi ligjor i Prefektit.

Problem që kërkon zgjidhje, përcaktimi i akteve normativ (Urdhëra e Urdhëresa) me një akt nënligjor (në formën e një evidence tip)

VI.3. Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për rritjen e performancës së të zgjedhurve vendor

Është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre ligjore, si dhe rritjen e performancës së organe të tyre.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore u është kërkuar zbatimi i detyrimit ligjor (neni 15 i Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”) për publikimin e akteve nga bashkia M.Madhe, Vau i Dejës, Pukë e Fushë Arëz; U është rikujtuar detyrimi i përcaktuar në aktin nënligjor, për marrjen e Vendimeve, të trajtimit të familjeve me ndihme ekonomike, brenda muajit; U është rikujtuar marrja e vendimeve në kushtet e konfliktit të interesit; Është bashkëpunuar për ndarjen e detyrave, sipas kompetencave midis të zgjedhurve dhe të emëruarve, kjo në rastet e paqartësive; U janë kaluar për shqyrtim e vlerësim kërkesat dhe ankesat e qytetarë dhe subjekteve të ndryshme, brenda kompetencës tyre, pavarësisht institucionit që i është drejtuar.

Janë organizuar takime të shumta për: Menaxhimin e mbetjeve; Mbarëvajtjen e sezonit turistik; Situatën e rendit dhe qetësisë publike; Përballimin e situatave emergjente; Çështjet e luftës kundër trafikimit të personave; Parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit; Vlerësimin e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore; Goditjen e informalitetit në sektorin e ujit të pijshëm

VII. FUNKSIONET E DELEGUARA, KRYERJA E VEPRIMTARISË NGA INSTITUCIONET TË CILAVE U JANË DELEGUAR FUNKSIONET NGA INSTITUCIONET QENDRORE

VII.1. Verifikimi i titujve të pronësisë mbi token bujqësore

Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut, ka ushtruar aktivitetin e tij në përmbushje me bazën ligjore dhe nënligjore, rekomandimet e Sekretariatit Teknik dhe detyrimet që pasojnë në funksion të zbatimit të ligjit Nr. 9948 datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi token bujqësore” i ndryshuar, VKM Nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përberjen, mënyren e funksionimit dhe detyrat e përgjegjesite e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi token bujqësore”, i ndryshuar, Kodi i procedurave administrative, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 2,

datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore nga KV – të kur këtë e kërkojnë individë apo institucione”, Udhëzimin nr. 1, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e krijimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish NB – ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin”, Rregullores ”Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Vendore” miratuar me Vendimin Nr. 1 të Komisionit Qeveritar të Tokës dt. 27.03.2009 si dhe akteve nënligjore të nxjerra për zbatim të ligjit, që janë, VKM Nr. 604, datë 05.09.2012, VKM Nr. 605, datë 05.09.2012 ”Për procedurat e njoftimit dhe mënyren e pagesës së detyrimit financiar në rastet e pavlefshmërisë së pjesshme të AMTP-ve, si rezultat i mosrespektimit të normës për frymë të tokës bujqësore”.

Për vitin 2017;

a. Në bazë të Udhëzimit Nr. 1, datë dt.13.01.2010 ”Për mënyren e verifikimit dhe shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore të ish NB dhe zonës së zhvillimit me përparësi turizmin”, në bazë të të cilit, KV ka ushtruar kontrollet direkte me objekt verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të AMTP – ve të plotësuar në tokat bujqësore të ish Ndermarrjeve Bujqësore të Qarkut Shkodër.

Fshati	AMTP per shqyrtim	Trajtuar me Vendim	Pezulluar	Ne proces
Berdice e Madhe	48	-	6	42
Shtoj i Ri	42	-	-	42
Rranxa	60	-	-	60
Berdice e Siperme	24	6	6	12
Berdice e Mesme	40	-	4	36
Rranxa 2016	15	9	3	3
Shtoj i Ri 2016	18	11	5	2
Grude e Re	56	36	15	5

b. Në bazë të Udhëzimit nr. 2, datë 13.01.2010 ”Për mënyren e verifikimit dhe shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, kur e kërkojnë individë dhe institucione”, në bazë të të cilit KV ka trajtuar 108 kerkesa nga institucione dhe individë, nga të cilat 41 janë në proces dhe 67 janë trajtuar me kthim-pergjigje.

Vendime Janar-Dhjetor 2017

Shfuqizim i plote	Shfuqizim i pjes.	Pezullim	Mosshqyrtim	TOTAL
28	41	65	1	135

Gjatë vitit 2017, janë zhvilluar 178 seanca gjyqësore

Gjatë vitit 2009-2017 kanë marrë formën e prerë 46 vendime në total, në të cilat është përfituar një sipërfaqe prej 26.568 Ha dhe të ardhura me një vlerë prej 8.972 mijë lekë

Lidhur me problematikat e evidentuara gjatë procesit të verifikimit, ZVRPP Shkoder, vijon te jete pengesa kryesore e plotesimit te praktikave administrative ne proces brenda afateve ligjore, ndonese nga ana e Institucionit, vazhdimisht janë vene ne dijeni Institucionet eprore te ZVRPP Shkoder, respektivisht Zyra Qendrore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Tirane dhe Ministrine e Drejtesise. Mungesa e informacionit dhe e dokumentacionit te ZVRPP Shkoder eshte problematika kryesore qe KV ka ne mbylljen e procedimeve administrative.

Ne te njejten linje, mungesa e kthim pergjigjeve zyrtare nga Dhoma e Noterise Shkoder vijon te pengoje KV ne plotesimin e metejsheem te praktikave administrative ne progres. Gjithashtu, Dhoma Kombetare e Noterise Tirane, ne kthim pergjigjet zyrtare nuk ka percjellur informacion te konfirmuar nese eshte çelur deshmia e trashegimise per subjektet e kerkuara pasi nuk i kemi bashkelidhur çertifikatat personale aktuale.

Ne korrespondencen zyrtare te zhvilluar me qellim plotesimin e praktikës administrative hetimore, kemi sqaruar Dhomen Kombetare te Noterise Tirane se çertifikatat personale te derguara nga Zyrat e Gjendjes Civile respektive, jane pjese e dosjeve te hapura per llogari te procedimeve administrative dhe bashkelidhur do te gjejne kopje te çertifikatave te njesuara me origjinalin.

Per me teper, vazhdon mungesa e aksesit ne portalin e.albania.com per te terhequr çertifikatat personale elektronikisht, ndonese Institucioni i Prefektit te Qarkut Shkoder ka bere kerkese per na u mundesuar aksesit ne kete portal, por ende nuk eshte kthyer pergjigje per sa me siper.

Ne te njejten linje, mungesa e kthim pergjigjeve zyrtare nga ZGJC Rrethina vijon te pengoje KV ne mbylljen e procedimeve administrative hetimore. Ne lidhje me keto problematika, KV Shkodër ka vene ne dijeni edhe Drejtorinmë e Përgjithshme të Zyrave të Gjendjes Civile.

Pezullimi i dosjeve administrative objekt verifikimi nga KV per shkak te vdekjes se mbajtesit te pare te titullit te pronesise AMTP apo anetareve te familjes bujqesore, ne rastet kur mungon deshmia e trashegimise, kur kjo konfirmohet nga institucionet pergjegjese, duke permendur ketu Dhomat Rajonale te Noterise, Dhoma Kombetare e Noterise dhe Gjykatave te Rrethit, perben gjithashtu problematike pasi KV nuk del me vendim perkatesisht, ndonese konstatohet paligjshmeria rast pas rasti.

VII.2. Shërbimet sociale

Verifikimi i ligjshmërisë së vendimeve të këshillave të njësive të vetëqeverisjes vendore, për shpërndarjen e ndihmës ekonomike, mbështetet në Ligjin Nr. 9355 date 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, VKM nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave të masës së ndihmës ekonomike”, me ndryshime, Udhëzimit Nr. 338/3 dt 10.03.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, te procedurave dhe te masës se ndihmës ekonomike”, gjatë të cilit janë kthyer të gjitha vendimet në rastet kur janë trajtuar familjet në një mase me te madhe se maksimumi i përcaktuar me ligj; I është kushtuar vëmendje që listat e familjeve përfituese duhet të jenë vetëm gra në përputhje me kriteret e përcaktuara ligjore; Është bërë kujtesë, rekomandime për zbatimin e kriterëve ligjore për

ndihmën ekonomike dhe paaftësinë në plotësimin e sakte të bazës ligjore në vendim, në përcaktimin e datës së shpalljes dhe e hyrjes në fuqi të VKB; Është terhequr vëmendja strukturave përgjegjëse për mosmarrjen e VKB brenda muajit siç përcaktohet nga akti nënligjor.

Me fondet e buxhetit janë kryer shpenzime gjatë vitit, për ndihmë ekonomike dhe pagesë të personave me aftësi të kufizuar, me vlerë 1,725,645 mijë lekë (Pagesë ndihme ekonomike 443,557 mijë lekë dhe pagesë paaftësie 1,282,088 mijë lekë)

Pagesat e për ndihmë ekonomike, për familjet në vështirsi ekonomike dhe pagesat për personat me aftësi të kufizuar, sipas njësive, paraqiten:

Nr.	Bashkia	Ndihmë ekonomike			Pagesë paaftësie		
		Mesatar mujor		Shuma vjetore (mijë lekë)	Mesatar mujor		Shuma vjetore (mijë lekë)
		Numri i familjeve	Vlera (mijë lekë)		Numri i persona	Vlera (mijë lekë)	
1	M.Madhe	2,204	9,525	113,095	1,438	14,566	174,800
2	Shkoder	3,640	14,276	171,315	7,450	62,570	750,885
3	Vau i Dejës	1,437	6,139	73,667	1,543	15,184	182,202
4	Pukë	820	3,659	43,911	680	5,913	70,951
5	Fushë-Arëz	758	3,464	41,569	496	8,604	103,250
	Qarku	8,859	36,963	443,557	11,607	106,837	1,282,088

Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror janë kryer 33 inspektime të planifikuara në 33 njësi, sipas të cilave janë konstatuar pagesa të tepërta të ndihmës ekonomike me vlerë 4,722 mijë lekë, për 667 familje, nga të cilat 443 janë trajtuar padrejtësisht, të cilat me rekomandimin e lënë janë larguar nga skema; Kanë përfituar, pagesa të tepërta paaftësie 453 persona me vlerë 3,640 mijë lekë, nga të cilët 95 persona, sipas rekomandimit janë larguar nga skema e PAK.

VII.3. Zhvillimi i territorit

Për zhvillimin e territorit nga ana e Insitucionit të Prefektit janë ndjekur problem te ndryshme të territorit si strehimi, pronësi dhe mjedisi. Janë ndjekur dhe mbikqyrur nismat për të gjitha hapat e caktuara për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe dhe Vau-Dejës, veprimtari e cila konsiston në pjesmarrjen në disa dëgjesa publike të ndërmarra nga Bashkia Shkodër dhe Malësi e Madhe, për hartimin e planit të përgjithshëm vendor, duke rekomanduar bashkërendimin e punës në të gjitha hapat që do të ndërmerren për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendorë konformë ligjit Nr. 107/2014 ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’ (bashki të cilat kanë miratuar në këshill bashkiak PPV).

Problemet në lidhje me distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës dhe lartësinë e ndërtesës, moszbatimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve të paligjshme nga ana e Inspektoriatit vendor të mbrojtjes së territorit, shqyrtimi i ndërtimeve paleje, shtesat anësore dhe në lartësi, në lidhje me pagesën e këstëve për shlyrjen për pëfitimin e programeve sociale të strehimit dhe probleme me ndotjen e mjedistit nga lëndët djegëse nga aktivitetet tregtare.

Është bërë konfirmimi i gen planeve të objekteve që privatizohen apo jepen me qera, objekte këto sipas Njesive Administrative të bashkive brenda territorit të qarkut. Është bashkëpunuar me agjensinë e Basenit Drin-Bunë për të gjitha problemet që janë paraqitur duke bërë verifikimin e problemeve sipas rasteve të paraqitura.

VII.4. Zhvillimi i turizmit

Nisur nga arritjet, viti 2017, ka qenë një vit i suksesshëm në zhvillimin e turizmit në qarkun tonë, arritje të cilat shihen qartazi, në rritjen e numrit të turistëve vendas dhe të huaj të cilët kanë vizituar dhe qendruar si turist, sipas destinacioneve turistike në qark, për rrjedhojë shtimin e të ardhurave nga turizmi.

VII.4.a. Objektivat vjetor;

- Garantimin e rendit dhe qetësisë publike, si dhe parandalimin e veprimtarisë kriminale në të gjitha plazhet dhe zonat turistike, nëpërmjet riorganizimit të shërbimeve të policisë në pikat e kontrollit dhe kontrollin e territorit në të gjithë vendin;
- Rritja e sigurisë rrugore në të gjitha akset dhe në rrugët e zonave turistike me përparësi, si dhe parandalimi i aksidenteve automobilistike nëpërmjet kryerjes së shërbimeve të drejtpërdrejta për drejtimin dhe monitorimin e trafikut veçanërisht në zonat turistike;
- Lehtësimi i hyrje-daljeve të shtetasve të huaj dhe vendas në kufi, nëpërmjet ofrimit të shërbimit cilësor dhe të shpejtë, duke shtuar shërbimet e Policisë Kufitare në pikat e kalimit kufitar;
- Përmirësimi i shërbimeve të policisë nëpërmjet rritjes së standardeve në përmbushjen e detyrës, etikës së komunikimit në shërbim, si dhe sigurimi i paraqitjes dinjitoze dhe komunikimit me qytetarët;
- Ofrimi i shërbimeve të ndihmës së shpejtë dhe zgjidhjes së problemeve për turistët dhe pushuesit, me prioritet në zonat turistike, në çdo rast nevojë, nëpërmjet krijimit të njësive policore të përkohshme dhe të lëvizshme, pranë qendrave dhe zonave turistike.
- Shmangien e informalitetit, goditjen e paligjshmerisë dhe invazionit fiskal në ushtrimin e veprimtarisë biznesit në zonat turistike, si dhe rritjen e të ardhurave nga turizmi, janë arritur

Progresi në zhvillimin e turizmit gjatë vitit, krahasuar me sezonin e vitit të kaluar ka ardhur nga përmirësimi i nivelit të bashkëpunimit dhe i veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor (duke veçuar bashkëpunimin dhe mbështetjen e strukturave të policisë vendore) dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, për kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësive për këtë sektor; Kështu,

- Është përmirësuar shërbimi shëndetësor, duke plotësuar jo vetëm në numër qendra shëndetësore me personelin e duhur, por duke qëndruar në gatishmëri e plotësuar të gjitha nevojat në zonat turistike;
- Nga ana e Autoritetit Kombëtar të rrugëve janë kryer rikonstruksione të pjesshme të rrugëve (vlen të veçohet ndërhyrja dhe rikonstruksioni në pjesë të veçanta të rrugës Harku i Berdicës-Velipojë), si dhe mirëmbajtja e akseve rrugore me destinacion turizmin;

- Janë marrë masat nga ana e policisë së shtetit për sigurinë publike në zonat turistike, si dhe nga policia e qarkullimit rrugor për parandalimin e aksidenteve gjatë sezonit;

- Nga ana e policisë kufitare janë marrë të gjitha masat për të ofruar një shërbim të shpejtë në lëvizjen e shtetasve të huaj e shqiptar (hyrje e dalje) në pikat kufitare (Muriqan, Hani i Hotit dhe Bashkim) si dhe për përdorimin e mjeteve motorike lundruese argëtuese (Si rezultat i masave të marra nga shërbimet e policisë kufitare, në stacionet e plazhit, nuk ka patur asnjë incident nga mjetet lundruese argëtuese gjatë sezonit turistik);

- Nga ana e Autoritetit Kombëtar të ushqimit janë kryer detyrimet në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit;

- Nga ana e organeve tatimore janë marrë masa kundër informalitetit, goditjen e paligjshmërisë dhe evazionit fiskal, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së biznesit nga subjektet private në zonat turistike:

- Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare është hartuar dhe zbatuar projekti në konservim dhe restaurim në Kalanë “Rozafa” Shkodër, kryesisht konsolidim elementesh konstruktiv të kullës nr.4 në oborrin e tretë dhe fugatime e kapuçit dhe muret perimatral të oborrit të dytë, projekte të cilat kanë ndikuar në rritjen e numrit të vizitorëve, si dhe duke shtuar edhe vendosjen e sistemit të biletarisë elektronike (investim i kryer me bashkëfinancim nga Fondi Shqiptaro Amerikan i Zhvillimit dhe Ministria e Kulturës, ka ndikuar në rritjen e të ardhurave

- Po kështu ka patur një përmirësim të punës së njësisë të vetëqeverisjes vendore për pastrimin e territorit në zonat turistike dhe menaxhimin e mbetjeve, organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturoro-artistike e sportive, marrjen e masave për shmangien e ndotjes akustike të gjeneruar nga subjekte dhe veprimtari të ndryshme gjatë sezonit, etj;

- Nga ana e Operatorit të shpërndarjes energjisë elektrike, nëpërmjet masave të marra (investime e mirëmbajtje në rrjetin e TM/TU, në nënstacion e kabina elektrike) është synuar furnizim pa ndërprerje me energji elektrike gjatë gjithë sezonit;

- Nga ana e Sh.A “Ujësjellës-Kanalizime” me masat e marra është siguruar një furnizim normal dhe me cilësi me ujë të pijshëm për zonat turistike dhe në mënyrë të veçantë i plazhit Velipojë, ku edhe është kërkuar një sasi shumë më e madhe, për arsye të përqendrimit të pushuesve gjatë sezonit veror.

Nga pikat kufitare gjatë vitit kanë hyrë dhe dale 3 089 158 shtetas (të huaj 1 903 667 shtetas) dhe 1 137 961 mjete (të huaja 702 297 mjete), nga 2 568 255 shtetas dhe 962 963 mjete gjatë vitit të kaluara, ose me një rritje respektive në masën 20.3 % dhe 18.2 %. Vetëm gjatë sezonit turistik veror kanë hyrë dhe dalë 1 259 276 shtetas dhe 429 660 mjete, nga 989 549 shtetas dhe 352 076 mjete gjatë të të njëjtës periudhë të vitit të kaluara (sezonit turistik veror 2016), ose me një rritje respektive në masën 27.2 % dhe me një rritje prej 12.2 %

Numri i vizitorëve në kalanë e Shkodrës, si një nga monumentet me të vizitueshme në juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, ka qenë 48700, ose rreth 10000 vizitor më shumë krahasuar me vitin 2016. Vetëm gjatë sezonit veror numri i vizitorve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar është rritur me rreth 6000 vizitor

Edhe numri i vizitorëve në Muzeumet e Shkodrës (Muzeun historik “Oso Kuka”, Muzeu e Kështjellës dhe Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës) është rritur, ku vetëm gjatë sezonit ka qenë rreth 13000.

Është rritur numri i pushuesve të akomoduar në strukturat akomoduese (Resort, Hotel, Motel, Bujtinë, etj). Në plazhin Velipojë, sipas numrit të netë/fjetje, janë akomoduar mesatarisht rreth 2500 pushues në ditë, Në pikën turistike Theth rreth 135 pushues në ditë dhe në qytetin e Shkodrës rreth 212 pushues në ditë; Në pikat turistike të M.Madhe (Razëm, Vermosh e zonën e Kelmëndit) rreth 50 pushues në ditë.

Është shtuar numri i subjekteve të regjistruara, të cilat ushtrojnë veprimtari në zonat turistike (Plazh Velipojë), krahasuar me sezonin e vitit të kaluar nga 534 në 589, ose 89 subjekte.

Është rritur xhiroja e subjekteve deklaruese të TVSh, mbi të cilën llogaritet TVSh, me mbi 132 milion lekë, ose 51 %, krahasuar me sezonin e kaluar (sezonin e vitit 2016)

Janë tejkaluar të ardhurat nga taksat vendore dhe tarifat, në zonat turistike, krahasuar me planin dhe me sezonin e vitit të kaluar

Bashkëpunimi i njëjësive të vetëqeverisjes vendore me Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë ka qenë i mirë; Nepermjet Qendres Shendetesore te Plazhit është ofruar shërbim shëndetësor 24 orësh, për pushuesit

Bashkëpunimi me struktura e policisë vendore ka qenë në nivele shumë të mira (Policia e Shtetit ka bashkëpunuar në lidhje me mbajtjen e rendit dhe të qetësisë në Njësinë Administrative Velipoje, ku si rezultat i këtij bashkëpunimi nuk është shënuar asnjë rast vjedhje apo raste të tjera të shkeljes së ligjit; Policia ka bashkëpunuar në mbajtjen e qetësisë në të gjitha organizimet kulturore sportive të organizuara nga ana e njëjësive të vetëqeverisjes vendore). Po kështu edhe me Policinë Kufitare dhe Migracionit bashkëpunimi ka qenë shumë i mirë, i gjithë fluksi i qarkullimit të shtetasve dhe mjeteve (hyrje e dalje) në pikat kufitare është përballuar, pa krijuar rradhe të gjata apo shqetësime tek qytetaret (Gjatë sezonit turistik veror për shkak të fluksit të madh në PKK-Muriqan dhe Hani i Hotit me qëllim moskrijimin e rradheve të gjata si në hyrje ashtu dhe në dalje është punuar me procedura të lehtësuara); Në bashkëpunim me policinë kufitare të Malit të Zi janë zhvilluar 249 patrulla të përbashkëta në kufi në parandalimin e zhvillimit të aktiviteteve të paligjshme; Është punuar mirë në drjetim të menaxhimit dhe disiplinimit të mjeteve lundruese në plazhin Velipojë dhe Shirokë, kështu është bashkëpunuar me bashkinë Shkodër për përcaktimin e zonës së shfrytëzimit të plazhit nga pushuesit, oraret dhe vendosjes e shënjave dalluese, vendet e përcaktuara për motorët dhe korridorët e hyrje-daljeve. Për sigurimin e rendit dhe qetësisë publike në plazhe janë planifikuara dhe kryer shërbim me 3 mjete lundruese (2 në plazhin Velipojë dhe 1 Shirokë) Si rezultat i masave të marra në bashkëpunim edhe me bashkinë Shkodër gjatë sezonit nuk ka patur asnjë incident të krijuar nga mjetet motorike. Gjatë sezonit u është dhënë ndihmë 143 pushuesve në 82 raste (Për shkeljet e konstatuara janë marrë 19 masa administrative, gjobë me vlerë 190 mijë lekë)

Në nivele të kënaqshme ka qenë bashkëpunim me Inspektoriatin e Mjedisit.

VII.4.b. Problematikat e hasura dhe koordinimi me aktorët e tjerë publik për sa i përket garantimit të sigurisë fizike të pushuesve, cilësinë e shërbimit, shëndetit publik, higjienës etj. të cilat kanë ndikuar dhe ndikojnë në mbarëvajtjen e turizmit:

- Gjendja ekzistuese e rrugëve në drejtim të zonave turistike, në veçanti e akseve rrugore të Njësive Administrative të zonës malore të Dukagjinit, e cila krijon vështirësi për lëvizjen e pushuesve.

- Trafiku i renduar i automjeteve gjatë sezonit, por në veçanti gjatë ditëve të fundjavës, gjatë segmentit Ura e Bahçallëkut-Harku i Bërdicës, problem i cili mund të zgjidhet me anën e një mbikalimi tek Harku i Bërdicës.

- Administrimi dhe menaxhimi i territorit dhe hapësirave publike (zënia forcërisht dhe përdorimi i hapësirave publike, sipërfaqe të territorit të plazhit, nga subjekte dhe individë për qëllime biznesi)

- Mos zbatimi i kriterëve dhe standardeve të përcaktuara në rregulloren “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së plazhit” (miratuar në VKM 369 datë 18.05.2016), në stacionet e plazhit, lidhur me vendosjen e kullave të vrojtimit gjatë gjithë gjatësisë së plazhit me vrojtues gjatë gjithë orarit të plazhit (neni 6/3.ç i rregullores) si dhe Moslejimin e shitësve ambulantë nga subjektet të cilat zhvillojnë veprimtari në hapësirat e marra me qira sipas kontratës (neni 5/6 i rregullores), në mënyrë të veçantë i atyre ambulantëve që përdorin bombolat e gazit, të cilët jo vetëm ndikojnë negativisht në imazhin e turistëve, por përbëjnë një rrezik për ta.

- Moszbatimi i kriterëve të përcaktuara për krijimin e sigurisë në plazhin Velipojë (Mos mbulimi i të gjithë gjatësisë së plazhit me kulla vrojtimi në distancën e përcaktuar për çdo 200-250 m plazh; Mungesa e trajnimit të vrojtuesve; Mungesa e pajisjeve me elementët përkatës të kullave të vrojtimit, përfshi pajisjet më elementare)

- Mungesa trajnimeve nga organizata apo Ministria përgjegjëse për turizmin, në lidhje me menaxhimin, përkujdesjen dhe mbarëvajtjen e turizmit.

- Çertifikimi i strukturave akomoduese, sipas klasifikimit dhe sipërmarrjeve turistike tyre.

- Mungesa e udhërrëfyesve turistik të çertifikuar.

- Cilësia e ujit të pijshëm të furnizuar nëpërmjet puseve të shpimit në zonën e plazhit Velipojë (jashtë kushteve dhe parametrave të përcaktuar për konsum) dhe që në vazhdim duhet eliminuar, duke kryer furnizimin vetëm nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit.

VII.4.c. Rekomandime

Nisur edhe nga problemet e hasura dhe pamundësia e njësive të vetëqeverisjes vendore në administrimin e stacioneve të plazhit, për një mirëmenaxhim dhe zhvillim të turizmit, rekomandojmë që stacionet e plazhit të administrohen nga një strukturë e veçantë e krijuar nga qeveria në shkallë vendi

VII.5. Shërbimi i gjendjes civile

Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile ka grumbulluar, administruar dhe kontrolluar aktet e gjendjes civile (lindje, martesë, vdekje) të mbajtura nga zyrat e gjendjes civile të bashkive

dhe NjA pjesë përbërëse e bashkive, mbështetur në Ligjin Nr. 10129, dt 11.05.2009 “Për gjendjen Civile”, me ndryshime (neni 32 “Administrimi dokumentacionit”), për cilat është dokumentuar dorëzimi (me procesverbal), duke dhe kryer lidhjet e këtyre akteve.

Janë lëshuar certifikata përkatëse (sipas kërkesave të shtetasve apo institucioneve të ndryshme), të gjëndjes civile, për dokumentacionin që administron vetë zyra, duke u bazuar në rregjistrat themeltarë si dhe në akte, fluksi i të cilave përveç nevojave të ndryshme është edhe në varësi të fazave të procesit të kompensimi të ish-pronareve e ish të përndjekurve politik, legalizimit dhe gjatë sezonit veror e në fund të vitit (periudhë në të cilin përkon me ardhjen pranë familjeve të shtetasve të cilët jetojnë jashtë vendit)

Është ndjekur zbatimi i vendimeve të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, bazuar në Ligjin “Për Gjendjen Civile” dhe Udhëzimin Nr.481, dt 05.09.2013 “Për procedurat e korrigjimit të emrit/mbiemrit si gabim material”, nga zyrat e Gjendjes Civile të bashkive dhe njësive administrative pjesë përbërëse e këtyre bashkive, duke bërë verifikimet në Rregjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

U është kthyer përgjigje, me informacionin e kërkuar, brenda afatit, kërkesave të Institucioneve të ndryshme si Prokuroria, Gjykata, Sigurimet Shoqërore, Drejtoria e Policisë apo Zyra Konsullore.

Është bashkëpunuar me zyrat e Gjendjes Civile për marrjen e masave në korrigjimin në afat dhe në menyrë korrekte nga punonjësit e këtyre zyrave

Ndryshimet e akteve ligjore e nënligjore”Për gjendjen Civile” u janë bërë të njohura zyrave të gjendjes civile brenda qarkut.

VIII. ORGANIZIMI DHE VEPRIMTARIA E ADMINISTRATËS

VIII.1. Organizimi dhe shpenzimet e kryera për zhvillimin e veprimtarisë

Administrata e Prefektit është e organizuar dhe funksionon, sipas strukturës së miratuar nga Kryeministri (Urdhër Nr. 11 dt. 12.01.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër”), si dhe e Komisionit vendor të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi token bujqësore, sipas strukturës së miratuar nga Këshilli i Ministrave (VKM Nr. 1269 date 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësive të strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi token bujqësore”, me ndryshime), me një organikë prej 33 punonjësish:

1.	Prefekt	1
1.1	Sekretar i Prefektit	1
2.	Sekretari i përgjithshëm	1
3.	Nënprefekt (Malësi e Madhe dhe Pukë)	2
4.	Spektori i monitorimit të kompetencave vendore dhe funksioneve të deleguara	6
5.	Spektori i zhvillimit urban	3

6.	Spektori i planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave	3
7.	Spektori juridik	3
8.	Spektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse	7
9.	Komisioni vendor i vlersimit të titujve të pronësisë	6

Në fakt administrata ka funksionuar me 3, 4 dhe 5 më pak (sipas periudhave të ndryshme gjatë vitit), pasi pozicionet e ponës kanë mbetur vakt, për arsye të moskryerjes së procedurave të konkurrimit dhe emërimit të punonjësve në keto pozicione (Aktualisht Spektori i Financës dhe shërbimeve mbështetëse 2; Spektori i Zhvillimit Urban 1; Spektori i planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave 1; Spektori Juridik 1)

Për zhvillimin e veprimtarisë, nga ana e Institucionit, janë kryer shpenzime me vlerë 31,909 mijë lekë, ose 90.2 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim fondesh prej 3,454 mijë lekë. Ndërsa nga zyra e gjendjes civile janë kryer shpenzime me vlerë 2,844 mijë lekë, ose 98 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 56 mijë lekë.

Programimi dhe përdorimi i fondeve, sipas programeve, në nivel art. Paraqitet, sipas pasqyrës:

Në mijë lekë

Art.	N/Art.	Emertimi i shpenzimeve	Programimi dhe përdorimi				
			Plan 2017	Ndrysh.	Plani me ndrysh.	Fakti	Dif.
Totali i shpenzimeve Administrata e Prefektit dhe Gjendja civile			34,067	4,196	38,263	34,753	3,510

Adminsitrata e Institucionit (Gr.16, T 1160, Kap. 1)

600		Paga, shperblime dhe te tjera shpenz. personeli	20,385	3,700	24,085	23,135	950
601		Kontribut per sigurime shoqerore dhe shendetesore	4,120	-	4,120	3,822	298
602		Mallra dhe sherbime te tjera	7,000	-	7,000	4,793	2,207
	6021	Materiale dhe sherbime zyre te pergjithshme	860	-	860	619	241
	0100	Kancelari e tjera	300	120	420	343	77
	0200	Mat. për pastrim,dizifek.,ngrohje dhe ndriçim	80	15	95	68	27
	0300	Materiale për funksionimin e zyreve	400	-135	265	209	56
	0500	Blerje dokumentacioni	10	-	10	-	10
	0900	Furnizim dhe materiale të tjera zyre e të përgjithshme	70	-	70	-	70
	6022	Sherbime nga te tretet	1,550	-	1,550	1,404	146
	2001	Elektricitet	500	-	500	446	54
	2002	Uje	80	-	80	62	18
	2003	Sherbime telefonike:	320	-200	120	94	26
		<i>Fikse</i>	200	-100	100	94	6
		<i>Celulari</i>	120	-100	20	-	20
	2004	Sherbime te tjera (Posta)	600	200	800	776	24
	2010	Sherbime të printimit dhe publikimit	50	-	50	26	24
	6023	Shpenzime transporti	885	-	885	699	186
	3100	Karburanti	650	-	650	589	61
	3200	Pjese kembimi , goma dhe bateri	150	-	150	78	72
	3300	Rregjistrim,kalaudim ,siguracion	35	-	35	32	3
	3900	Te tjera	50	-	50	-	50
	6024	Shpenzime udhetimi	150	100	250	218	32
	4100	Udhetim i brendshem	150	100	250	218	32
	6025	Shpenzime per mirmbajtje te zakonshme	450	-100	350	197	153
	5600	Shpenzime per mirmbajtjen e mjeteve te tansportit	150	-	150	87	63
	5800	Shpenzime per mirmbajtjen e paisjeve te zyreve	200	-	200	110	90
	5300	Shpenzime per mirmbajtjen e objekteve ndertimore	100	-100	-	-	-
	6027	Shpenzime per detyrime dhe kompensime legale	2,805	-	2,805	1,619	1,186
	602.74	Shpenzime per vendime gjyqsore për largim nga puna	1,462	500	1,962	1,619	343
		Shpenzime për detyrime të tjera	1,343	-500	843	-	843
	6029	Shpenzime te tjera operative	300	-	300	38	262
	602.9	Shpenzime per pritje percjellje	50	-	50	-	50
	602.91	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime	150	-	150	8	142
	602.9	Shpenzime per tatime,taksa,rregjistrim pasurie nga inatit. etj.	100	-	100	30	70
606		Transferta per buxhete familjare dhe individe	-	158	158	158	-
230		Shpenzime per rritje te A.Q. te patrupsuara	-	-	-	-	-
231		Shpenzime per rritjen e A.Q. Te trupsuara	-	-	-	-	-
		Shuma:	31,505	3,858	35,363	31,909	3,454

Gjendja Civile (Gr.16, T 1170, Kap. 1)

600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenz. personeli	2,167	313	2,480	2,437	43
601	Kontribut per sigurime shoqerore dhe shendetesore	395	25	420	407	13
602	Mallra dhe sherbime te tjera	-	-	-	-	-
	Shuma	2,562	338	2,900	2,844	56

VIII.2. Urdhërat e nxjerra dhe zbatimi i tyre

Për bashkërendimin e veprimtarive të institucioneve qendrore në nivel vendor dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe realizimin e detyrave nga administrata e Institucionit nga Prefekti janë nxjerrë 55 Urdhra, me problematika të ndryshme, të cilat janë zbatuar, sipas afateve të përcaktuara

Administrata ka zbatuar në të gjitha rastet urdhërat e nxjerrë, duke siguruar në këtë mënyrë efektivitetin e tyre.

Është bërë konfirmimi i genplaneve në mbështetje dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të ministrave Nr. 926 datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”.

VIII.3. Takimet e organizuara në funksion të kryerjes së veprimtarisë

Veprimtaria e organit këshillues të prefektit të qarkut në zbatim të nenit 23 të ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut”

Në funksion të kryerjes veprimtarisë dhe ushtrimit të përgjegjësiave nga ana e Prefektit janë zhvilluar takime të shumta, përfshirë edhe takimet e grupit këshillues pranë Prefektit (sipas fushave dhe sektorëve të veprimtarisë), takime të cilat në formë të përmbledhur, sipas çështjeve të trajtuara, paraqiten:

- Mbi marrjen e masave të sigurisë, në kuader të protestës së organizuar nga shoqata e të përmyturve të viteve 2010-2011 dhe paralajmërimit për greve urie në ambientet e institucionit të Prefekti (Takim datë 24 Janar)

- Mbledhje e Këshillit të Bazenit Ujëmbjdhës Drin-Bunë, si dhe miratimi i Vendimeve përkatëse (takim datë 13 Shkurt; 10 Prill; 5 Shtator, 14 Dhjetor)

- Mbi vlersimin e situatës së thertoreve dhe tregtimit të mishit të bagëtive në qarkun Shkoder. Problematika e perseritur që kërkon investim për tregun e mishit dhe peshkut në tregun e Rusit dhe në disa zona të tjera (takim datë 17 Shkurt)

- Problematikat dhe marrja e masave, për krijimin e infrastrukturës së nevojshme, për zgjedhjet parlamentare të Qershorit 2017, nga ana e institucioneve përkatëse rajonale; takim i cili u organizue me pjesëmarrjen e prezencës së OSBE-së në vendin tonë (takim datë 20 Shkurt)

- Mbi çështjet e luftës kundër trafikimit të personave, takim i Komitetit Rajonal kunder Trafikimit të Personave. Në takim u paraqit një panoramë e pergjithshme e situates duke referuar edhe rastet konkrete të trafikimit të vajzave kryesisht të zonave malore, apo të komunitetit rome për qellime shfrytëzimi (takim datë 5 Prill)

- Mbi problematikat në kuader të luftës kunder kultivimit të bimeve narkotike (zbatimi i planit të veprimit antikanabis 2017-2020). Në takime u evidentua fakti se ka një përmirsim të dukshëm në zbulueshmërinë e rasteve të mbjelljes së bimëve dhe venies para përgjegjësive ligjore të autoreve. Në takime u diskutua edhe integriteti i punonjësve të policisë së shtetit gjatë ushtrimit të detyres. Edhe një here u theksua se duhet ndryshime në ligj duke hequr përgjegjshinë e kryepelqve në rastet e kultivimit të kanabisit në zonat e tyre të përgjegjshisë (takim datë 10 Prill, 26 Maj, 23 Shtator)

- Në lidhje me marrjen e masave për përballimin e emergjencave civile, gjatë sezonit veror 2017; si dhe evidentimi i kapaciteteve njerzore dhe logjistike kryesisht për përballimin e rasteve të zjarreve dhe shuarjen e tyre, takim me pjesëmarrjen edhe të Drejtorit të Përgjithshëm të EC (takim datë 20 Prill)

- Mbi marrjen e masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në qarkun Shkoder. Në takim u diskutuan problematikat e automjeteve zjarrfikese të cilat janë në gjendje të amortizuar, përgjegjshinë e autoreve të zjarrvënies së qëllimshme, nderhyrjet me helikopter në zonat ku nuk shkojnë zjarrfikeset, organizimin e grupeve vullnetare (takim datë 4 Korrik; 11 Gusht)

- Mbi marrjen e masave për përballimin e situatave të pritshme emergjente në qarkun e Shkodres. Si rezultat i rreshje të dendura të shiut, në zonen e nënshkodres janë krijuar probleme të mëdha si pasoje e mosnderhyrjes në pastrimin e kanaleve kulluese si nga ana e Njesive të Qeverisjes Vendore ashtu edhe nga ana e bordit të kullimit Shkoder, si dhe gjatë aksit Harku Berdicës-Trush-Ura e Gon Lulit nga punimet për ndërtimin e rrugës (takim date 30 Nëntor dhe 2 Dhjetor)

- Mbi menaxhimin e situatës së rreshjeve, me pjesëmarrjen edhe të Zv.kryemistres zj. Mesi, takim në të cilin u vlersua situata në qarkun Shkoder, ku më e rënda ishte humbja e jetës së tre elektrikistave të OSHEE, bllokimi i Qafe-Thorës, shkarjet e dheut në disa zona, demtimi i disa shkollave dhe spitalit në rrethin Pukë (takim datë 1 Dhjetor)

- Mbi problemin e bllokimit aksit rrugor Bogë-Qafe Thore-Theth (takim datë 15 Dhjetor me drejtues të institucioneve, si dhe takim me banorët e fshatit Theth)

- Në lidhje me zbatimin e Urdhërit të Kryeministrit nr.65, për rregulloren dhe zbatimin e etikës së punonjësve gjatë fushatës elektorale. Ndalimin në mënyre kategorike të marrjes pjesë së administratës në fushatë gjatë orarit të punës (takim datë 25 Maj)

- Mbi masat për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik 2017; Takim i Komitetit Rajonal të Turizmit-Evidentimi i masave të marra nga të gjithë institucionet për përballimin me sukses të sezonit turistik 2017, kryesisht me garantimin e furnizimit me energji elektrike, me ujë të pijshëm, shërbim shëndetsore, disiplinimin e ndotjes akustike etj. në zonat turistike bregdetare ashtu edhe ata malore. Problem mbetet edhe infrastruktura rrugore (takim datë 31 Maj dhe 16 Qershor)

- Mbi të drejtat e punonjësve në administratën publike; Njohja e të drejtave dhe detyrimeve të çdo punonjësi, në zbatim të legjislacionit (takim datë 19 Korrik)

- Mbi zhvillimin e turizmit dhe sigurinë publike. Në takim drejt. e tatim-taksave theksoj se vazhdon me kontrollet për subjektet e palicensuara, drejt e UK theksoj se ka një përmirsim të furnizimit me ujë të pijshëm, kërkoj nderhyrjen për prishjen e stallave në

stacionin e Trushit. Policia e shtetit ka problem ndotjen austike, kerkoj koordinimin me ISHMP. Policia kufitare ka vendosur korridore per mjetet motorike (takim datë 3 Gusht)

- Mbi marrjen e masave për mbarëvajtjen e procesit mësimor, gjatë vitit arsimor 2017-2018, duke u përqendruar tek shpërndarja e teksteve, gjëndja e ambienteve në të cilat zhvillohet mësimi, plotësimi i institucioneve arsimore me punonjës mësimor kryesisht shkollat e zonave malore, problemet e transportit të nxënësve dhe mesuesve, ngrohja në shkolla, etj. (takim datë 8 Shtator)

- Mbi menaxhimin e burimeve ujore dhe inerteve në qarkun Shkoder, në zbatim të urdherit të kryeministrit, i cili ndalon në menyrë kategorike marrjen e inerteve ne shtreterit e lumenjve deri në një urdher të dyte duke perjashtuar rastet për rruget me rendësi kombetare (takim datë 13 Nëntor)

- Mbi marrjen e masave për përbalimin e situatave të EC për sezonin e dimrit. Angazhimi i gjithë strukturave për situatat të pritshme me rreshje shiu dhe permbytje ashtu edhe të izolimit nga debore për zonat malore (takim datë 21 Nëntor)

- Mbi verifikimin e rasteve të ndertimeve pa leje në zonën turistike të Thethit, verifikimet e rasteve të paisjeve me AMTP të banoreve të zonës (takim datë 23 Nëntor)

- Mbi funksionimin e taske forcës së therjes dhe tregtimit të mishit të bagetive (takim datë 12 Dhjetor)

- Mbi problemet e pronësisë dhe bashkëpunimit mes Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë dhe Hipotekës, DAMT, Aluiznit, probleme të cilat priten të marrin fund me krijimin e agjensia e trajtimit të pronësisë (takim datë 13 Dhjetor)

- Mbi gjendjen e infrastrukturës rrugore të fshatit Bardhaj dhe domosdoshmërin e ndërhyrjes për rikonstrukcion, sipas kërkeses së banorëve të fshatit (takim datë 2 Dhjetor)

- Takime të tjera, në kuader të bashkëpunimit ekonomik, turistik, social-kulturor mes Greqisë dhe Shqipërisë (datë 18 Dhjetor me Ambasadorin e Greqisë); Takim prezantues i Prefektit me drejtues të institucioneve qendrore në nivel rajonal dhe me administratën (datë 6 Nëntor)

VIII.4. Vlerësimi dhe trajtimi i ankesave të shtetasve

Ushtrimi i përgjegjësisë së Prefektit, për shqyrtimin e ankesave dhe zgjidhjen e konflikteve, është kryer duke zbatuar kërkesat e kodit të procedurave administrative (Ligji Nr.44/2015, datë 30.04.2015)

Gjatë viti në Institucionin e Prefektit janë shqyrtuar dhe vlerësuar, duke kthyer përgjigje 80 kërkesa dhe ankesa të qytetarëve, kërkesa dhe ankesa të ardhura direkt, ose nepermjet institucioneve të tjera qendrore, të cilat sipas problematikës paraqiten:

- Për çështjet e pronësisë dhe zënien e hapësirave publike 22
- Për mjedisin e menaxhimin e mbetjeve 6
- Për çështjet e punësimit 4
- Për çështjet e strehimit 3
- Për dëmshpërblim dhe emergjencat 4
- Për shërbimin e furnizimit me energji elektrike (OSHEE) 6
- Për pagesën e Ndihmës ekonomike, Paaftësisë dhe invaliditetit 4

- Për shërbimin e transportit 1
- Për masa administrative (falje gjoba) 1
- Të tjera 29

VIII.5. Veprimtaria e N/Prefektit

Në përbërje të administratës së prefektit, mbështetur në nenin 22 të Ligjit 107/2016, datë 27.10.2016 “*Për Prefektin e qarkut*”, kanë zhvilluar veprimtarinë nënprefektët Malësi e Madhe dhe Pukë.

Nënprefekti ka ushtruar detyrat funksionale, përcaktuar në detyrat e administratës së Prefektit (miratuar me Urdhrin Nr. 50, datë 12.04.2017, të Kryeministrit) dhe në Rregulloren Organizative të Brendshme të Institucionit, Kështu;

Ka bashkëpunuar me institucionet qendrore në nivel vendor, duke kërkuar prej tyre marrjen e masave për realizimin e detyrave, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre,;

Në kuadër të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarive të institucioneve qendrore në nivel vendor, si dhe të ketyre institucioneve me bashkitë janë organizuar takime gjatë vitit për problemet e rendit, të turizmit, emergjencave;

Nga ana e nënprefektit janë marrë masat për zbatimin e urdhrave të nxjerra nga prefekti.

Pranë nënprefektëve kanë funksionuar zyrat e ankesave të qytetarëve dhe subjekteve që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të tyre;

Janë konfirmuar çertifikatat e lëshuar nga ana e punjonjësve të gjëndjes civile të bashkive dhe NjA pjesë perbërëse e bashkive, si dhe brenda kompetencave ligjore janë lëshuar dokumente të tjerë, sipas kërkesave të qytetarëve;

Për problemet e dala në bashkitë që mbulojnë është raportuar vazhdimisht gjatë vitit tek Prefekti.

IX. VEPRIMTARI TË TJERA TË PREFEKTIT

Mbështetur në Ligjin Nr.8378, datë 22.7.1998 “*Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar, Nr.10279, datë 20.05.2010 “*Për Kundravajtjet Administrative*”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë Punëve të Brendshme Nr.687, datë 5.12.2013 “*Për mënyrën e evidentimit dhe të shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese, administrimi i gjobave dhe pasqyrat statistikore në fushën e qarkullimit rrugor*”, i ndryshuar, neni 19, nga ana e Prefektit është shqyrtuar dokumentacioni i sjellë nga Drejtoria vendore e policisë në 66 raste, duke marrë vendimet përkatëse

X. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2018

Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i mëtejshëm profesional i punonjësve të administratës, duke qenë faktor i rëndësishëm për të siguruar menaxhim efektiv dhe të suksesshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, do të jetë nga drejtimet kryesore të punës, për arritjen e objektivave:

1. Realizimi i programit qeverisës në nivel qarku (*Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë së Degëve Territoriale dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së tyre, në realizimin e detyrave dhe objektivave, duke kërkuar transparencë; Përgjegjshmëri; Komunikim dhe informim; Llogaridhënie; Ashpërsim të luftës ndaj fenomenit të korrupsionit*)

2. Përballimi i situatave emergjente të krijuara gjatë gjithë vitit nga kushtet atmosferike, apo nga faktor të tjerë (*Marrja e masave për përballimin e situatave emergjente; Përmirësimi i sistemeve të identifikimit të rrezikut dhe fuqizimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm; Rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive në nivel qarku e më gjërë dhe lehtësimi i shkëmbimit të informacionit mbi zvogëlimin e rrezikut ndaj fatkeqësive dhe të mbrojtjes civile; Fuqizimi i aspekteve të gatishmërisë, shërbimeve emergjente dhe kapaciteteve të rikuperimit; Nxitja e krijimit të mbrojtjes financiare të mjaftueshme për përballimin e situatave emergjente*)

3. Parandalimi dhe goditja e individëve dhe grupeve kriminale, si dhe fenomeneve që paraqesin rrezik për jetën dhe pronën; Godja dhe shkatërrimi i kultivimit të kanabisit, duke e nxjerrë përfundimisht qarkun Shkodër nga harta e kultivimit; Sigurimi i rendit publik (*Bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarisë me strukturat e policisë së shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera ligjzbatuese*)

4. Përmirësimi i nivelit të shërbimit ndaj qytetarëve, nepermjet ushtrimit të funksioneve brenda kompetencave dhe veprimtarisë (*Bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për ushtrimin e funksioneve të transferuara, si dhe monitorimi i kryerjes së këtyre funksioneve dhe përdorimi i fondeve të dhëna nga qeveria për këtë qëllim*)

5. Goditja e informalitetit dhe zgjidhja e qëndrueshme në shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm (*Bashkërendimi i veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor, me njësitë e vetëqeverisjes vendore, përfshi shoqëritë aksionere të UK*)

6. Krijimi i një mjedisi të pastër brenda territorit të qarkut, në kuadrin e nismës së ndërmarrë nga qeveria “*Të pastrojmë Shqipërinë që duam*” (*Bashkëpunimi dhe koordinimi i punës me institucionet në nivel vendor, njësitë e vetëqeverisjes vendore, subjektet private, shoqërinë civile, shoqata mjedisore, etj.*)

7. Përmirësimi i shërbimit të furnizimit me energji elektrike nga ana e Drejtorisë Rajonale të OShEE Sh.A; Përmirësimi i treguesve ekonomik-financiar dhe performancës; Ulja e nivelit të humbjeve në kufijtë e pranueshëm (*Bashkëpunimi, koordinimi i veprimtarisë së institucioneve rajonale, njësitë e vetëqeverisjes vendore me Degën Rajonale të OSHEE Shkodër, si dhe monitorimi i veprimtarisë*)

